



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

STUDIME PASDIPLOMIKE-CIKLI I DYTË

Teza:

**“Ndikimii eksportit në zhvillimin e ekonomisë – rastii
Republikës së Maqedonisë”**

KANDIDATIMENTORI

ArditaNesimi

Prof.Dr.Nasir Selimi

Tetovë, 2019

Abstrakt

Zhvillimi ekonomik i paqëndrueshëm dhe nën potencialin e saj, e shoqëron prej shumë vitesh ekonominë e Republikës së Maqedonisë, e cila karakterizohet nga një ekonomi konsumi. Në këto kushte një vëmendje e madhe i kushtohet zhvillimit të investimeve dhe eksporteve.

Ky punim shkencor vlerëson në çdo aspekt të segmentit të eksporteve të Republikës së Maqedonisë dhe koston e kapitalit të tyre për vendin. Segmenti teorik dhe analiza makroekonomike zë peshën më të madhe të punimit, historiku dhe konceptin bazë të eksporteve në Republikën Maqedonisë dhe në rajon, rritjen ekonomike të Republikës së Maqedonisë si dhe ndikimin e shkallës së eksportit në te dhe një ndërlidhje të mundshme në mes eksportit dhe rritjes së ekonomisë së Republikës së Maqedonisë si dhe trendin statistikor dhe fuqinë e kësaj lidhjeje apo ndikimit.

Të dhënat e punimit janë seri kohore me frekuencë vitore (2001-2017). Seritë kohore përbëhen nga indikatorët ekonomik më të rëndësishëm të vendit tone, edhe ate analizohen dhe komparohen koeficientet dhe shkallët e indikatorëve makroekonomik të vendit me nivelet e eksportit, edhe ate duke përdorur metodat statistikore të Granger Causality Test, testi Augmentet Dikey Fuller (ADF), më pas metodat e korelacionit dhe regresionit linear të pasqyruara në forma grafike dhe tabelare. Nga gjetjet e punimit, rezulton se: Shkalla e eksportit ka ndikim sinjifikantë tek rritja e ekonomisë së vendit (PBB-ja dhe PBB-ja për kokë banori) si dhe tek varijablat tjera makroekonomike të potencuara në këtë hulumtim ku vlen të potencohet lidhja e eksportit me shkallën e papunësisë, e gjithë kjo duke u bazuar tek të dhënat e Entit statistikor dhe Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë.

Fjalë kyçe: *Ekonomia e Maqedonisë; Eksporti; Parametrat makroekonomik;Produkti bruto i Mbrendshëm; Produkti Bruto i Mbrendshëm për kokë banori; Papunësia;*

PËRMBAJTJA

Abstrakt.....	2
1. Hyrje	5
2. Lënda dhe qëllimi i studimit	7
3. Hipoteza e studimit	7
4. Rëndësia e studimit	8
5. Metodologjia e hulumtimit	9
6. Metodatat statistikore dhe teknikat empirike.....	10
7. Organizimi dhe struktura e hulumtimit.....	10
I. KAPITULLI I PARË	12
Konceptet themelore e hulumtimit	12
1.1 Globalizimi, Ekonomia dhe Eksporti.....	12
1.1.1 Nocioni i Eksportit nëpërmjet parametrave të Republikës së Maqedonisë, rajonit dhe parametrave të ekonomive evropiane	15
1.2 Faktorët kryesorë të gritjes dhe stabilizimit të ekonomisë së një shteti.....	27
1.3 Lidhja e ndërsjelltë tregti - investime të huaja direkte - eksport.....	30
1.4 Lidhja e ndërsjelltë tregti-punësim me theks tek eksporti	32
1.5 Eksporti dhe Tregtia ndërkombëtare.....	34
1.6 Avantazhet dhe kostot e Investimeve të huaja direkte (IHD)	37
1.7 Prodhimi I Brendshëm Bruto (Rritja ekonomike) dhe eksporti i mallrave.....	44
II. KAPITULLI I DYTË	49
Ekonomia e Republikës së Maqedonisë dhe gjendja aktuale	49
2.1 Dy dekadat tranzitive e ekonomisë së Republikës së Maqedonisë.....	49

2.2 Gjendja aktuale e ekonomisë së Republikës së Maqedonisë	53
2.2.1 Perspektiva dhe Rreziqe.....	58
2.3 Eksportet - Republika e Maqedonisë dhe Ballkani Perëndimor	59
III. KAPITULLI I TRETË	64
Pjesa empirike e studimit	64
3.1 Mënyrat e të studijuarit të ndikimit të Eksportit në Rritjen ekonomike	64
3.2 Shpërndarja e vlerave makroekonomike të Republikës së Maqedonisë prej 2001-2016 ...	65
3.3 Statistikat konkluzive ekonomike dhe interpretimi i hipotezave.....	72
3.5 Diskutimi i rezultateve.....	78
IV. KAPITULLI I KATËRT	80
Përfundimi dhe rekomandime.....	80
4.1 Përfundimi.....	80
4.2 Rekomandime	81
Bibliografia	82

1. Hyrje

Eksportii mallrave dhe i shërbimeve përfaqëson një burim shumë të rëndësishëm të ardhurave nga shkëmbimi me shtetet e jashtme, dhe si pasojë bënë uljen e presionit në bilancin e pagesave (për shkak të uljes së deficitit tregtar). Një strategjie mirëfilltë ekonomike për rritjen e eksportit ka për qëllim të stimulojë prodhuesit që të eksportojnë mallrat e tyre jashtë, përmes politikave të ndryshme ekonomike. Po ashtu, këto politika ekonomike synojnë për të rritur aftësinë dhe kapacitetet për ato firma të cilat janë në gjendje për të konkurruar në tregun botëror, duke ju siguruar kështu teknologji të përparuara, dhe po ashtu për të siguruar shkëmbime të huaja të nevojshme për të importuar mallra kapitale (d.m.th eksportet bëhen për të paguar mallrat e importit). Eksportet mund të rrisin tregtinë brenda industrisë, të ndihmojnë vendin që të integrohet në tregjet ndërkombëtare, dhe kështu ato bëjnë që të zvogëlohet ndikimin i goditjeve (recesioneve) të jashtme në ekonominë e vendit. Përvoja e ekonomive të Azisë dhe të Amerikës Latine japin shembuj të mirë për rëndësinë e sektorit të eksporteve në rritjen ekonomike dhe zhvillimin ekonomik. Ekspertet e ekonomisë vlerësojnë se roli i eksportit është thelbësor për zhvillimin e një shteti.

Efektii tregtisë së jashtme në rritjen ekonomike ka qenë një subjekt i rëndësishëm i debatit për disa dekada. Shumë studime të mëparshme kanë gjetur një lidhje pozitive midis normës së rritjes së tregtisë së jashtme dhe normës së rritjes së prodhimit.

Zhvillimi ekonomik është njëri nga objektivat kryesorë të çdo shoqërie në botë, dhe rritja ekonomike është thelbësore për zhvillimin ekonomik. Të shumët janë kontribuuesit në rritjen ekonomike, mirëpo eksporti është konsideruar si një nga kontribuuesit më të rëndësishëm.

Ekziston një literaturë e gjerë që analizon lidhjet teorike midis eksporteve dhe rritjes ekonomike. Sipas kësaj literature, marrëdhënia midis eksporteve dhe rritjes ekonomike përcaktohet nga faktorë të ndryshëm. Në mënyrë të qartë, pasi që eksporti është komponent i PBB-së, rritja e eksporteve kontribuon direkt në rritjen PBB-së. Po ashtu eksportet ndihmojnë shtetet e varfra dhe me treg të vogël, të përfitojnë nga shtetet me ekonominë e shkallës (Helpman dhe Krugman 1985).

Përveç kësaj, eksportet çojnë në përmasimin e shpërndarjes të burimeve, dhe në veçanti shfrytëzimin e përmirësuar të kapitalit për shkak të konkurrencës në tregjet botërore. (Balassa 1978).

Shumica e autorëve që kanë publikuar punime në lidhje me raportin në mes të eksportit dhe GDP kanë arritur në përfundim se në përgjithësi ekzistojnë katër pikëpamje në këtë drejtim.

Sipas këndvështrimit të parë, gjegjësisht hipotezës së neoklasikëve në lidhje me eksportin, jepen këto pikëpamje:

- Zgjerimii eksportit do të rrisë produktivitetin, dhe po ashtu do të rrisë ekonominë e shkallës. (Helpman dhe Krugman 1985).
- Zgjerimii eksporteve sjell produkte me kualitet më të lartë për shkak të ekspozimit të eksportuesit ndaj kërkesave të konsumatorëve ndërkombëtar (Krueger 1985).
- Eksportet do të ndikojë që një firmë të investojë në teknologji të reja, si strategji për angazhimin e rritjes së shkallës së outputit. (Ghirmay, Grabowski and Sharma 2001).
- Një qasje e orientuar kah eksporti në ekonominë që kanë tepriçë të fuqisë punëtore, mundësojnë rritje të shpejtë të punësimit dhe rritjen e pagave reale. (Krueger 1985).
- Eksporti kontribuon në relaksimimin e pengesave në këmbimin e jashtëm.

Këndvështrimii dytë është lidhja shkak-pasojë e cila shkon nga rritje ekonomike të eksportet. Produktiviteti më i lartë do të thotë kosto më e ulët për njësi, dhe kjo rezulton në lehtësimin e rritjes së eksporteve. Rritja ekonomike ndikon në rritjen e eksporteve në qoftë se produkti brendshëm rritet më shpejt se kërkesa e brendshme. (Shan dhe Tian 1998).

Këndvështrimii tretë, është një kombinim i pikëpamjeve, e cila sugjeron se mund të ketë një marrëdhënie dypalëshe shkakësore midis eksporteve dhe rritjes ekonomike.

Dhe këndvështrimii katërt ku sipas saj, nuk ka ndonjë lidhje shkakësore ndërmjet eksportit dhe rritjes ekonomike, rritja e eksportit dhe e ekonomisë është rezultat i zhvillimit dhe ndryshimit teknologjikë.

Pra, nga ky kontekst themi se lënda e hulumtimit në fjalë do të jetë konceptii eksportit dhe ndikimit apo impaktit të tij ndaj rritjes ekonomike të shtetit, në këtë rast të Republikës së Maqedonisë.

2. Lënda dhe qëllimii studimit

Një nga arsyt kryesore të studimit është që të përshkruhen në mënyrë të qartë eksportet si një tregues i rëndësishëm i bashkëpunimit ndërkombëtar, duke përfshirë ndikimin e eksportit në zhvillimin e një shteti në përgjithësi e në veçanti analizën e lidhjes kauzale të eksportit mbi rritjen ekonomike në Republikën e Maqedonisë. Poashtu, qëllimi i tezës është që të nxjerrë në pah disa kontributet e helbësore teorike-empirike në fushën e ndikimit të parametrave makroekonomike tek rritja ekonomike, në këtë rast impakti i eksportit ndaj rritjes ekonomike të Republikës së Maqedonisë dekadën e fundit si dhe të senzibilizohet opinioni gjërë me peshën e ndikimit të shkallës së eksportit në rritjen ekonomike të vendit.

Qëllimi kryesor i kësaj teze është të përshkruajë, analizojë dhe vlerësojë lidhjen kauzale ndërmjet shkallës apo nivelit të eksportit dhe rritjes ekonomike në Republikën e Maqedonisë në periudhën prej vitit 2001 deri në vitin 2017. Ky qëllim do të arrihet duke analizuar fillimisht pjesëmarrjen e shkallës së eksportit në Republikën e Maqedonisë dhe më pas të analizohet nëse të njëjtat do ndikojnë në mënyrë signifikante në rritjen ekonomike duke studiuar treguesit kryesor të rritjes ekonomike siç janë: PBB, nivelin dhe ecurinë e punësimit, inflacionit, etj.

Për t'i arritur këto qëllime do të parashtrohen disa pyetje kërkimore:

- Si dhe sa ndikon shkalla e eksportit në rritjen ekonomike nëpërmjet rritjes së Bruto Prodhimit Vendor?
- Çfarë ndikimi sjell shkalla e eksportit në rritjen e parametrave makroekonomikë në Republikën e Maqedonisë?

Çfarë lidhshmërie ka midis eksportit dhe importit dhe cili është ndikimi i shkallës së eksportit në investimet vendore dhe të huaja? E tjerë.

3. Hipoteza e studimit

Duke pasur parasysh përmbajtjen e detyrës, objekti dhe qëllimi i hulumtimit, që duam të arrijmë, ne kemi formuar hipotezë kryesore zero si rrjedhojë logjike nga vetë hipoteza kryesore, edhe atë duke u nisur nga fakti se shumë studime të kryera më parë tregojnë një lidhje të drejtë midis nivelit të shkallës së eksportit dhe rritjes ekonomike dhe duke u bazuar në qëllimin dhe pyetjen kërkimore që është parashtruar edhe hipotezën hulumtuese në vijim:

H1: Nuk ka ndikim signifikant midis shkallës së eksportit dhe rritjes ekonomike në Republikën e Maqedonisë.

4. Rëndësia e studimit

Aktualisht qëllimii çdo vendi në zhvillim është që të arrijë një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, gjë që kërkon arritjen e një rritjeje të vazhdueshme ekonomike. Një nga parakushtet e rritjes ekonomike është stabiliteti makroekonomik. Midis mendimeve të ndryshme nga shkolla të ndryshme lidhur me stabilitetin makroekonomik, treguesit kryesorë të stabilitetit makroekonomik janë inflacioni, papunësia, bilanci pagesave, eksporti dhe importi dhe rritja e prodhimit. Çdo përkeqësim i këtyre variablave shpie në mungesën e stabilitetit makroekonomik. (Shiferaw, 2012)

Prandaj, duke parë rëndësinë e këtyre treguesve makroekonomikë, qëllimii veçantë i këtij punimi është që të analizojë lidhjen dhe ndikimin e shkallës së eksportit ndaj rritjes ekonomike në Republikën e Maqedonisë.

Objektivii përgjithshëm i këtij punimi është të japë një kontribut teorik dhe empirik për të kuptuar rolin që kanë disa nga faktorët e rëndësishëm makroekonomikë në rritjen ekonomike të Republikës së Maqedonisë. Gjithashtu punimi synon të jap rekomandime mbi politikat makroekonomike që duhet të hartohen për të rritur nivelin e rritjes ekonomike mbështetur në marrëdhënien që ekziston midis këtyre faktorëve. Për fat të keq, në Republikën e Maqedonisë, si në shumë vende të tjera në tranzicion, eksporti karakterizohet nga një paletë të kufizuar mallrash dhe shërbimesh si rrjedhojë të nivelit të ulët të zhvillimit të industrisë dhe segmenteve tjera kyçe të cilët janë shtylla kryesore të ekonomisë së vendit si dhe nga ana tjetër vlen të potencohet edhe rrolin e deficitit tregtar të Republikës së Maqedonisë si vlerësues së eksportit në përgjithësi, pra, në periudhën janar – korrik të vitit 2018, ka qenë 1.289.063.000 dollarë amerikan apo me fjalë tjera mbulimiimportit me eksport, në periudhën janar – korrik 2018 ka qenë 75.3 për qind. Prandaj rekomandimet dhe konkludimet e këtij hulumtimi do të mund të jenë ndihmesë dhe shtesë e politikave ekonomike për mirrëqenien e vendit tonë.

5. Metodologjia e hulumtimit

Ky punim analizon lidhjen dhe ndikimin që ka eksporti ndaj rritjes ekonomike në Republikën e Maqedonisë duke përdorur tre lloje metodash:

(1) një *analizë teorike* mbi eksportin si një dukuri makroekonomike, format e eksportit dhe rolin që kanë treguesit makroekonomisë ndaj rritjes ekonomike (PBB);

(2) një *analizë përshkruese* mbi situatën makroekonomike në Republikën e Maqedonisë, politikat e tregut të punës, reformat strukturore, duke identifikuar problematikat e dekadës së fundit;

(3) një *analizë empirike* duke përdorur një model regresioni bazuar në metodën e Granger Causality Test, testi Augmentet Dikey Fuller (ADF) duke përfshirë Analizën e regresionit, metodën e koeficienteve të ndryshëm të korelacionit ku identifikohen lidhjet midis variablave. Specifikisht, metodologjia e punimit përbëhet nga hapat e mëposhtëm:

- ✓ Ndërtimii pyetjeve kërkimore dhe zhvillimii tyre.
- ✓ Trajtimii bazave teorike dhe analiza e gjetjeve të literaturës së huaj, dhe studimeve vendase mbi lidhjen eksport-rritje ekonomike.
- ✓ Analiza e problematikës makroekonomike në Maqedoni me fokus eksportit dhe treguesit makroekonomikë që ndikojnë mbi të.
- ✓ Ndërtimii modelit empirik, grumbullimi, përpunimii të dhënave dhe nxjerrja e rezultateve.
- ✓ Nxjerrja e përfundimeve dhe rekomandimeve.

Për të përmbushur objektivat e këtij punimi kërkimor është ndërmarrë rishikimii një literature të gjerë që fokusohet në shpjegimin e kësaj lëmie, si dhe burime dytësore që përfshijnë studime të mëparshme e raste studimi në këtë fushë, raporte, tabela statistikore, baza të dhënash në internet; etj.

Punimi është bazuar në kërkime e materiale ekzistuese nga këto lëmi dhe në të dhëna konkrete sa u përket këtyre treguesve në Republikën e Maqedonisë duke zbatuar dhe metoda ekonometrike për ndikimin që ka eksporti dhe rritja ekonomike në Republikën e Maqedonisë gjatë kësaj periudhe kohore.

Ky studim përfshin gjithashtu edhe elemente kërkimi sasior, si analiza e të dhënave statistikore dhe përpjekje për të shpjeguar ecuritë dhe për të dhënë analizuar tendencat e zhvillimit.

Për realizimin e këtij punimi janë përdorur dhe të dhëna sekondare., Këto të dhëna janë siguruar nga burime të publikuara dhe janë kryesisht të dhëna nga Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Enti Statistikor i Republikës së Maqedonisë, Banka Qendrore e Republikës së Maqedonisë, Ministria e Financave të Republikës së Maqedonisë, Agjencioni për Punësim i Republikës së Maqedonisë; etj.

6. Metodat statistikore dhe teknikat empirike

Në këtë hulumtim në fillim do të pasojë përshkrimi i koncepteve kryesore të hulumtimit begatuar me analiza kualitative si dhe nga anafjetër edhe analizat kuantitative sidomos në pjesën empirike. Metodat statistikore që do të përdoren për përpunimin e të dhënave dhe interpretimin e hipotezave në hulumtimin tonë, do të jetë metoda statistikore e frekuencave deskriptive me grafikone dhe diagrame dhe e dyta është ajo e statistikave konkluzive të Granger Causality Test, testi Augmentet Dikey Fuller (ADF) duke përfshirë Analizën e regresionit, koeficientëve të korrelacionit, domethënë të dhënat do të përpunohen me programin statistikor për përpunimin e të dhënave IBM SPSS (Statistical Package for Social Sciences), versioni 21 i vitit 2015 dhe softverit Eviews 8.

7. Organizimi dhe struktura e hulumtimit

Ky hulumtim përbëhet nga pesë kapituj, duke përfshirë këtu hyrjen, rishikimin e literaturës, sistemin makroekonomik të Republikës së Maqedonisë, vlerësimin ekonometrik të hulumtimit, si dhe përfundimet dhe rekomandimet.

Kapitulli parë është një kapitull hyrës i punimit, në të cilin trajtohet rëndësia dhe qëllimi kryesor i hulumtimit, objektivat e veçanta dhe rezultatet e pritshme, organizimi i hulumtimit, metodologjia e përdorur dhe burimet e të dhënave.

Në kapitullin e dytë trajtohet literatura bazë që ka të bëjë me këtë temë, duke filluar me zhvillimet e fundit botërore makroekonomike sa i përket eksportit dhe rritjes ekonomike duke vazhduar më tej me përkufizimin e nocioneve bazë dhe nën nocioneve sipas lidhshmërisë me fushën e hulumtimit. Në këtë kapitull paraqiten gjithashtu, edhe vlerësimet teorike dhe empirike të marrëdhënies që ekziston midis eksportit dhe rritjes ekonomike.

Në kapitullin e tretë trajtohet sistemi makroekonomik i Republikës së Maqedonisë. Në këtë kapitull analizohet tendenca e Produktit të Brendshëm Bruto si tregues i rritjes ekonomike,

dhe ecuria e eksportit dhe importit, si treguesit kryesorë që ndikojnë në qëndrueshmërinë e kësaj rritjeje.

Kapitulli katërt ndalet në një vlerësim ekonometrik të ndikimit të eksportit dhe rritjes ekonomike në Republikën e Maqedonisë. Vlerësimi ekonometrik bëhet duke shfrytëzuar metodën e Granger Causality Test, testi Augmentet Dikey Fuller (ADF) duke përfshirë Analizën e regresionit, metodën e koeficienteve të ndryshëm të korelacionit, me të cilin jepen vlerësime të ndikimit të eksportit dhe rritjes ekonomike në Republikën e Maqedonisë, për periudhën kohore 2005-2017.

Kapitulli pestë përmbledh rezultatet dhe jep rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjet kryesore dhe diskutimet e ngritura gjatë këtij punimi.

I. KAPITULLI PARË

Konceptet themelore e hulumtimit

1.1 Globalizimi, Ekonomia dhe Eksporti

Bota sot karakterizohet me trende interesante dhe të shpejta. Në botën në të cilën jetojmë, sot mund të konsumojmë çdo produkt ngado që është prodhuar. Trendët globale tregojnë se çdo javë 1 milion persona lëvizin nga fshatrat në qytete, që do të thotë 4 milionë persona në muaj lëvizin nga fshatrat në qytete. Për herë të parë në historinë e njerëzimit sot ka më shumë persona të cilët jetojnë në qytete sesa në fshatra. Sot ka më shumë persona të cilët vuajnë nga mbipeshja, sesa persona të cilët vuajnë nga uria. Trendët demografike tregojnë se në disa shtete të botës ka më shumë persona të moshuar 65-70 sesa fëmijë 1-4vjet. Kjo tregon se popullsia botërore është duke u vjetruar. Trendët globale tregojnë se India në vitin 2030 do të jetë shteti me popullimin më të madh në botë, ndërsa në vitin 2020 Kina pritet që të jetë ekonomia më e madhe në botë duke kaluar SHBA-të¹.

Për herë të parë në historinë e njerëzimit klasa e mesme apo personat me të ardhura mesatare i tejkalojnë ata me të ardhura të vogla. Të gjitha këto trende janë pjesë e globalizimit. Globalizimi sot është një proces i cili përfshin lëvizjen e lirë të mallrave, shërbimeve, kapitalit, dhe po ashtu të njerëzve. Tregues të globalizimit p.sh janë: Sa persona janë duke e përdorur internetin, sa persona janë duke udhëtuar si turist, sa shkëmbime ditore të parave janë bërë etj.

Të gjithë e dimë se globalizimi është një proces i cili është duke ndodhur mirëpo a ekziston ndonjë mënyrë për ta matur atë? Njëra nga mënyrat për matjen e globalizimit është nëse analizojmë Indikatorët agregat global.

¹Guillén, Mauro F. *Symbolic Unity, Dynastic Continuity, and Countervailing Power: Monarchies, Republics, and the Economy*. Social Forces, 37. 2018.

Disa nga treguesit agregat të globalizimit								
Indikatorët:	1980	1985	1990	1995	2000	2005	2010	2015
A. Ekonomik:								
Eksportet + importet e të mirave dhe shërbimeve si % e GDP-së.	38.4	37.8	38	41.8	48.8	53.7	56	58.9
Shtetet e zhvilluara, si % e GDP-së.	39.5	39.1	38	40.9	48.1	52	55.9	61.1
Shtetet në zhvillim, si % e GDP-së.	32.8	31.2	38.1	46.4	52.5	62	56.7	63.7
Investimet e huaja direkte, si % e GDP	6.5	8.3	9.4	11.3	23.1	25.2	29.7	32.4
Shtetet e zhvilluara, si % e GDP-së.	4.9	6.5	8.9	10.8	22.7	25.3	30.7	39.1
Shtetet në zhvillim, si % e GDP-së.	11.8	14.7	13.6	16.4	40.1	50.2	60.3	72.2
B. Financiar:								
Shkëmbimet ditore të parave, si % GDP-së botërore.	0.7	1.3	3.8	5.6	6.8	4.6 k	6.3	7.2
Asetet e jashtme bankare ndërkufitare, % e GDP-së	13.7	19.9	28.1	28.5	34.2	54	47.9	49.3
Kreditë bankare dhe depozitat ndërkufitare si % e GDP	13.9	19.0	34.3	33.1	37.6	39.1	34.9	33.3
C. Interneti:								
Përdoruesit, % e popullsisë së botës.	...	...	0.1	0.8	6.7	16	30.2	63.5
Shtetet e zhvilluara	...	...	0.3	3.7	30.5	59.4	73.4	87.5
Shtetet në zhvillim	...	...	0	0	1.5	7.3	21.5	59.8
D. Demografia.								
Emigrantët ndërkombëtarë, % e popullsisë botërore	2.2	2.3	3	2.9	2.9	3	3.1	5.5
Popullsia e refugjatëve, % e popullsisë botërore	...	...	...	0.3	0.2	0.1	0.2	0.6
Remitancat nga punëtorët, % e GDP-së botërore.	0.41	0.39	0.42	0.36	0.43	0.63	0.75m	0.67
F. Kultura								
Turistët ndërkombëtarë % e popullsisë botërore.	3.5	6.7	8.6	9.5	11.4	13	13.7	19
Libra mbi temën e globalizimit	577	1107	2152	4853	10525	22405	38440	43545

Burimi: Mauro Gullen "Analyzing Global Trends for Business and Society" online course through coursera, Wharton School University of Pennsylvania.

Në qoftë se e shikojmë agregatin e parë: Eksportet + Importet si % e GDP-së vërejmë se në vitin 1980 ato përbënin vetëm 38% të GDP-së, ndërsa në vitin 2010 ato përbëjnë 56% të GDP-së Botërore. Një pjesëmarrje përafërsisht e njëjtë vërehet si në vendet e zhvilluara ashtu edhe në atonë zhvillim. Nëse e analizojmë më thellë, do të shohim se vendet në zhvillim kanë rritur pjesëmarrjen e tyre më shpejtë se sa vendet e zhvilluara, kështu që në vitin 2005 tregtia ndërkombëtare si përqindje e GDP arrin në 62%. Po ashtu në qoftë se e shikojmë Internetin si indikator me rëndësi, e shohim se në vitin 2000 vetëm 6.7% e popullsisë së botës e kanë përdorur internetin, ndërsa në vitin 2010 afërsisht 30.2% e botës e përdor internetin. Nga tabela vërehet setë gjithë indikatorët agregat të globalizimit kanë pasur trende të rritjes përgjatë periudhës 1980-2010.

Në kontekst të globalizimit, flasim edhe për tregtinë ndërkombëtare. Për tregtinë ndërkombëtare fillimisht u shfaqen merkantilistët. Merkantilistët argumentuan se një shtet mund të zhvillohet ekonomikisht në qoftë se zhvillon eksportin dhe eliminon importin. Ata ishin për

proteksionizëmmaksimal, duke përdorur kuota dhe tarifa të majme. Sipas tyre, mallrat të cilat eksportohehin jashtë, në shkëmbim të tyre ata fitonin ari. Kur kishte më shumë pronësi të arit, shtetëzhvilloheshin më shumë dhe më shpejt. Si rezultat i këtij zhvillimi, krijoheshin mundësi të reja punësimi, mirëqenie më e mirë për qytetarët e kështu me radhë, po ashtu ata mund të investonin në ushtri që e bënte shtetin edhe më të fuqishëm. Ata konstatonin se rritjen ekonomike e krijon rritja e eksportit. Mirëpo kjo rritje ekonomike bëhej në kurriz të shteteve tjera.

Pikëpamje të ndryshme për tregtinë ndërkombëtare kishte Adam Smithi. Ai mendonte se shtetet përfitojnë nga tregtia e jashtme, mirëpo që ky përfitim të jetë i dyanshëm, ato duhet të shkëmbejnë me njëra tjetrën. Ai thoshte se shtetet duhet të specializohet në ato të mira ku kishin përparësi absolute. Kjo do të thotë se një shtet është më efikas në prodhimin e një produkti (d.m.th mund ta prodhojë atë produkt me kosto më të ulët), atëherë ai shtet duhet që ta eksportojë atë të mirë dhe ta importoj të mirën tjetër ku ka disavantazh absolut d.m.th koston e prodhimit është më e lartë.

Rikardo ishte në pajtim me Smithin deri në një masë, mirëpo ai mendonte se një shtet duhet që të specializohet në një produkt ku ka përparësi krahasuese, d.m.th ku e ka koston oportune më të vogël. Duke u specializuar shtetet në ato produkte ku kanë përparësi krahasuese, bëhet përdorimi më eficient i resurseve. Përfundimisht Adam Smithi dhe Rikardo argumentuan se tregtia ndërkombëtare është faktori kyç për zhvillim ekonomik.

Eksporti i mallrave dhe i shërbimeve përfaqëson një burim shumë të rëndësishëm të ardhurave nga shkëmbimi me shtetet e jashtme, dhe si pasojë bënë uljen e presionit në bilancin e pagesave (për shkak të uljes së deficitit tregtar). Nga ana tjetër, rritja e investimeve të huaja është kyçe për rritjen e nivelit të eksportit të vendit por investitorët e huaj duan të investojnë në vendet ku ekonomia dhe situata politike janë të qëndrueshme. Ata nuk kanë besim për të investuar në vendin ku performanca politike dhe ekonomia janë të dobëta. Është i njohur si psikologjia e investitorëve dhe efektet e bandwagon (Selimi, 2016).

Efektet e tregtisë së jashtme në rritjen ekonomike ka qenë një subjekt i rëndësishëm i debatit për disa dekada. Shumë studime të mëparshme kanë gjetur një lidhje pozitive midis normës së rritjes së tregtisë së jashtme dhe normës së rritjes së prodhimit.

Zhvillimi ekonomik është njëri nga objektivat kryesorë të çdo shoqërie në botë, dhe rritja ekonomike është thelbësore për zhvillimin ekonomik. Të shumët janë kontribuuesit në rritjen ekonomike, mirëpo eksporti është konsideruar si një nga kontribuuesit më të rëndësishëm.

1.1.1 Nacioni Eksportit nëpërmjet parametrave të Republikës së Maqedonisë, rajonit dhe parametrave të ekonomive evropiane

Eksporti në ekonomi nënkupton transportimin e të mirave ose materialeve nga një vend në një tjetër në mënyrë legjitime sipas rregullave dhe standardeve të vendeve pjesëmarrëse në një ndërrim mallrash ose të mirash. Eksportimi i mallrave bëhet drejt konsumatorëve të huaj në një shtet tjetër nga ai prodhues i atyre mallrave.

Eksporti veprim i kundërt i importit është shumë i rëndësishëm për një vend dhe për pjesëmarrjen e atij vendi në tregun ndërkombëtarë. Teoria e tregtimit ndërkombëtarë dhe politikës së rregullimit të tregtisë ndërkombëtare është një nga degët më të vjetra të ekonomisë botërore në përgjithësi. Elemente të ekzistimit të tregtisë ndërkombëtare dokumentohen qysh në Greqinë Antike e gjer në kohën e sotme gjë pa të cilën nuk mund të paramendohet jeta në ditët e sotme. Gjatë historisë së ekzistimit të ekonomisë ndërkombëtare vende të ndryshme në periudha të ndryshme kanë pasur qasje të ndryshme ndaj eksportit gjë që ndikon në paraqitjen e fazave të dallueshme të zhvillimit të politikës ndërkombëtare të eksportit.

Ekonomitë e vendeve që lidhen me njëra-tjetrën nëpërmjet eksportit dhe importit, quhen ekonomi të hapura. Shkalla e hapjes së një ekonomie shprehet nëpërmjet raportit të vëllimit të eksport-importit ndaj GDP. Sa më i madh të jetë ky raport, aq më e hapur është ekonomia e një vendi. Zakonisht vendet më të zhvilluara kanë shkall më të lartë të hapjes së ekonomisë. Për të shpjeguar pse ndodh kështu, para së gjithash, duhet analizuar pse egziston tregtia ndërkombëtare, pse vende të ndryshme importojnë dhe eksportojnë mallra dhe shërbime: Eksporti përfaqëson shitjen e mallrave dhe shërbimeve të një vendi në vende të tjera, kurse importi blerjen e mallrave dhe shërbimeve nga vendet e tjera. Eksporti dhe importi i mallrave dhe shërbimeve është një domosdoshmëri që kushtëzohet nga një varg faktorësh:

Kushtet e ndryshme të prodhimit - Kushtet e prodhimit, ku përfshihen burimet natyrore, toka, kapitali, teknologjia, kushtet natyrore, janë të ndryshme në vende të ndryshme, prandaj edhe sasia, llojllojshmëria, cilësia e mallrave dhe e shërbimeve që prodhojnë vend të ndryshme nuk janë të njëjta. Për shembull, vendet me klimë të ngrohtë specializohen në prodhimin e frutave tropikale, sported që lidhen me detin, etj., kurse vendet me klimë të ftohtë specialohen në prodhimin e mishit të kafshëve që rriten në këtë klimë si dreri polar, peshku, etj. dhe në sportin e skive, etj.

Ekonomizimet e shkallës - Në shumë firma dhe degë të ndryshme, me rritjen e madhësisë së tyre të prodhimit vihet re rënia e kostos për njësi. Këtë dukuri e kemi quajtur ekonomizim të shkallës. Parë në aspektin ndërkombëtar, ato vende të cilat kanë fituar një pozicion superior në prodhimin e një produkti të caktuar kanë avantazhin e ekonomizimeve të shkallës. Prandaj ato specializohen në prodhimin e këti produkti, duke e eksportuar në vende të ndryshme që nuk e kanë këtë pozicion dhe që do të duhej të zgjeronin shumë madhësin e prodhimit për të përfituar nga ekonomizimet e shkallës, gjë që do të kërkonin investime të mëdha.

Ndryshimet në shijet - Edhe në qoftë se kushtet e prodhimit do të ishin të njëjtë për çdo vend, përsëri do të ishte e leverdishme të eksportohej dhe të importohej, përderisa shijet ndryshojnë nga një vend në tjetrin. Për shembull, supozojmë që Shqipëria dhe Greqia prodhojnë në të njëjeten sasi mish qengji dhe mish pule, por shqiptarët pëlqejnë më shume pulat, kurse grekët pëlqejnë më shumë qingjat. Edhe në këtë rast është e qartë që do të rritet kënaqësia e shqiptarëve dhe e grekëve, që vjen nga konsumi mishit, në qoftë se do të shkëmbehej një sasi mish qengji dhe mish pule midis Shqipërisë dhe Greqisë.

Sidoqoftë, arsyeja kryesore që qëndron në themel të faktorëve të mësipërm, e që bën të domosdoshme tregtinë ndërkombëtare, është një nga parimet më themelore të ekonomisë, që njihet si parimi i avantazhit krahasues. Ky parim i rëndësishëm kushtëzon këmbimin e të mirave dhe shërbimeve midis individëve Brenda vendit dhe midis vendeve të ndryshme dhe buron nga ndarja shoqërore e punës, që çon në rritjen e rendimentit të saj. Thelbi i avantazhit krahasues qëndron në pohimin që çdo vend mund të përfitojë nga tregtia me vendet e tjera, edhe në qoftë se nuk gëzon asnjë avantazh absolute. Mjafton që çmimi relative (kostoja oportune) i mallit të eksportuar të jetë më i ulët se ai i mallit të importuar. Avantazhi absolute shpreh aftësinë e një vendi për të prodhuar, me të njëjtat burime, një sasi më të madhe produkti se sa vendet e tjera.

Nëse i referohemi sqarimit të nocionit të eksportit me një analizë konçize duke u mbështetur në agregatet dhe parametrat ekonomike reale atëherë me disa shembuj konkret si numerik ashtu edhe kualitativ do të japin një pasqyrë më të hapur dhe më të qartë, pra, si fushë hulumtimi referohemi Republikës së Maqedonisë si dhe ekonomive të rajonit dhe ato evropiane, ku mund të potencojmë si për fillim se Maqedonia në pesë muajt e parë të vitit 2018 ka eksportuar mallra me vlerë prej 2.759.963 mijë dollarë amerikanë, duke u rritur me 29.1 për

qind, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (tabela 1 te pjesa empirike e hulumtimit), publikon Entit Shtetëror të Statistikave².

	Eksporti në(000 USD)
2010	3 351 429
2011	4 478 313
2012	4 015 417
2013	4 298 772
2014	4 964 132
2015	4 530 077
2016	4 854 746
2017	5 671 466

Burimi: Enti Statistikor i Maqedonisë (<http://makstat.stat.gov.mk>)

Sipas të dhënave të publikuara, vlera e mallrave të importuara për këtë periudhë arriti në 3.694.366 mijë dollarë amerikanë, 24.2 për qind më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të viti kaluar. Deficiti tregtar, për periudhën janar-maj 2018, arriti në 934.403 mijë dollarë amerikanë³. Kurse impaktii eksportit në PBB e shtetit si më poshtë tek tabela:

	Ndikimi në GDP (%)																
	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Eksporti	29.2	26.3	27.7	30.7	34.8	37.8	44.1	43.2	32.8	39.8	47.1	45.4	43.4	47.7	48.7	50.7	55.4

Burimi: Enti Statistikor i Maqedonisë (<http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat>)

Në eksportet, më shumë kanë marrë pjesë katalizatorët e transporteve me metalet të çmuara ose përbërjet e tyre, grupe telash ndezjeje dhe të ngjashme, pjesët e ulëseve të automjeteve për transportin e 10 ose më shumë personave. Më shumë është importuar platini dhe lëgura e platinit, vajrat e naftës dhe vajrat e fituara nga mineralet bituminoze, si dhe produktet e sheshta të bëra prej hekuri ose çeliku i papërpunuar. Më shumë është bërë tregti me Gjermaninë, Belgjikën, Britaninë e Madhe, Greqinë, Serbinë dhe Bullgarinë⁴.

²<http://www.stat.gov.mk/OblastOpsto.aspx?id=19>

³ Po aty

⁴ Po aty

Shkëmbimii mallrave të Republikës së Maqedonisë 2018, sipas vendeve, të dhënat cumulative nga Enti Statistikor i Maqedonisë - <http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat>

			Vlera në dollar
2018M11	Eksporti	AE Emiratet e Bashkuara Arabe	3 094 190
		AR Argjentinë	2 142 018
		AT Austri	157 264 543
		AU Australia	5 987 423
		BA Bosnje dhe Hercegovinë	85 498 995
		BE Belgjikë	245 223 020
		BG Bullgari	337 754 846
		BR Brazil	2 945 306
		NGA Bjellorusi	2 091 418
		CA Kanada	12 121 992
		CH Zvicër	44 307 675
		CN Kinë	55 932 919
		CO Kolumbi	104 347
		CY Qipro	710 598
		CZ Republika Çeke	73 873 131
		DE Gjermani	2 959 125 519
		DK Danimarkë	7 024 068
		EE Estonia	3 433 715
		EG Egjipt	1 160 639

Shkëmbimii mallrave të Republikës së Maqedonisë 2018, sipas vendeve, të dhënat cumulative nga Enti Statistikor i Maqedonisë - <http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat>

			Vlera në dollar
		ES Spanjë	109 734 796
		FI Finlandë	959 022
		FR Francë	56 021 879
		GB UK	114 081 719
		GE Georgia (Gjeorgji)	350 619
		GR Greqi	209 656 978
		HK Hong Kong	4 956 882
		HR Kroacia	95 594 082
		ID Indonesia	3 237 450
		IE Irlandë	284 571
		IL Izrael	6 312 286
		NË Indi	25 800 442
		IQ Iraku	2 848 578
		IR Iran	1 166 296
		Islanda	77 459
		IT Itali	204 714 314
		JP Japoni	522 865
		KR Korea e Jugut	2 474 771
		LI Lihtenshtajni	24 812

Shkëmbimii mallrave të Republikës së Maqedonisë 2018, sipas vendeve, të dhënat cumulative nga Enti Statistikor i Maqedonisë - <http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat>

			Vlera në dollar
		LU Luksemburg	1 072 741
		LV Letoni	4 394 383
		MA Marok	1 131 646
		MD Moldavia	2 604 325
		ME Malin e Zi (që nga viti 2006M01)	32 078 370
		MX Meksikë	4 471 297
		MY Malajzia	208 213
		NL Holandë	94 264 156
		JO Norvegji	3 036 673
		PL Poloni	63 417 646
		PT Portugalia	5 992 167
		QA Katar	6 778 665
		RO Rumani	182 323 620
		RS Serbia (nga 2006M01)	251 465 447
		RU Rusi	33 316 096
		SA Arabia Saudite	647 606
		SE Suedi	23 191 450
		SI Sllovenia	86 016 524
		SK Sllovaki	62 981 317

Shkëmbimii mallrave të Republikës së Maqedonisë 2018, sipas vendeve, të dhënat cumulative nga Enti Statistikor i Maqedonisë - <http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat>

			Vlera në dollar
		TR Turqia	85 349 048
		TW Tajvan	1 200 334
		UA Ukrainë	8 761 447
		SHBA SHBA	60 426 135
		XK Kosova (që nga viti 2009M01)	240 684 774

Eurostat ka publikuar të dhënat kryesore mbi tregtinë midis BE dhe Ballkanit Perëndimor. Në vitin 2017, Maqedonia është lidere në eksportet, me mbi 80% të mallrave në BE me vlerë 4 miliardë euro.⁵

Më pas rendite Bosnja dhe Hercegovina me 4 miliardë euro ose 71% të mallrave, me tej vjen Serbia me 9.7 miliardë euro. Vendii katërt është Shqipëria me 1.6 miliardë euro dhe në fund të listës është Mali i Zi me 0.1 miliardë euro. Eurostat ka dhe një shpjegim, BE-ja thotë në raportin është partneri kryesor i importeve të mallrave në Maqedoni.

Rezulton se në vitin 2017, bilanci i mallrave të BE-së me Ballkanin Perëndimor shënoi një tepriçë prej 9 miliardë euro, duke u rritur me 10% krahasuar me vitin 2016. Mësohet se 22 vendet anëtare të BE regjistruan një suficit dhe kyeson Hungaria, Greqia dhe Kroacia prej + 1.1 miliardë euro secila. Ndërsa deficiti më i madh u vu re në Suedi me - 66.4 milionë euro.

Vendet anëtare të BE-së, vazhdojnë të jenë eksportuesit më të mëdhenj në Ballkanin Perëndimor. E para është Gjermania me 16% të eksporteve të mallrave të BE në Ballkanin Perëndimor dhe më pas vjen Italia . Këto dy shtete përbëjnë mbi një të tretën e të gjitha eksporteve në këtë rajon.

Vlen të potencohet faktin se Maqedonia është në vendin e 28-të në botë sipas eksportit të verës, ndërsa në vendin e 173-të sipas importit, publikoi faqja e specializuar ndërkombëtare për

⁵<https://ec.europa.eu/eurostat/web/nuts/statistical-regions-outside-eu>

statistikë. Vitin e kaluar 2017 nga eksportii verës vendi ka realizuar 52,4 milionë dollarë që është 0,1 për qind nga eksporti në korniza botërore⁶.

Vlera e importit të Maqedonisë, vitin e kaluar ka arritur në 699.000 dollarë që është 0.002 për qind nga eksporti në botë, edhe ate shkëmbimi i mallrave dominon në këto sektorë:

Shkëmbimii mallrave nga sektorët e mallrave dhe seksionet 2018, të dhënat cumulative nga Enti Statistikor i Maqedonisë - <http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat>

		Eksporti
		Në dollar
2018M11	Ushqime dhe kafshë të gjalla	346 570
	Kafshët e kafshëve, përveç kafshëve të Divizionit 03	2 051
	Mishi dhe përgatitjet e mishit	28 907
	Produktet e qumështit dhe vezët e shpendëve	17 317
	Peshqit (përveç gjitarëve detarë), krustaceve, molusqeve, jovertebrorëve dhe përgatitjeve të tyre	4 210
	Drithëra dhe drithëra të përpunuara	84 182
	Perimet dhe pemët	159 702
	Sheqeri, i përpunuar nga sheqeri dhe mjalti	9 574
	Kafe, çaj, kakao, erëza dhe produktet e tyre	17 053
	Produktet ushqimore (përveç drithërave në kokrra)	986
	Produkte të ndryshme për ushqim dhe përpunim	22 586
	Pije dhe duhan	212 869
	Pije	68 766
	Duhani dhe produktet e duhanit	144 103

⁶<https://ec.europa.eu/eurostat/web/nuts/statistical-regions-outside-eu>

Shkëmbimii mallrave nga sektorët e mallrave dhe seksionet 2018, të dhënat cumulative nga Enti Statistikor i Maqedonisë - <http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat>

		Eksporti
		Në dollar
	Lëndët e para (përveç ushqimit) përveç karburantit	350 351
	Lëkurë të papërpunuar dhe lesh jo të mbuluar me qime	3 657
	Fara vaji dhe farëra vaji	1 109
	Goma bruto (përfshin sintetike dhe rigjeneruese)	6
	Tapë dhe dru	2 151
	Celuloza dhe mbeturinat e letrës	4 139
	Fibrat tekstile (përveç shiritave të leshit dhe leshit tjetër të krehur) dhe mbetjet e tyre (të papërpunuara në fije ose pëlhure)	1 645
	Lëndë drusore bruto, përveç nga ndarja 56, dhe mineralet e papërpunuara (përveç qymyrit, vajit, gurëve të çmuar)	62 561
	Mineralet metalike dhe skrap metali	255 151
	Materialet e papërpunuara të kafshëve dhe perimeve;	19 931
	Karburantet minerale, lubrifikantët dhe produktet e ngjashme	108 744
	Qymyri, koks dhe briketa	249
	Nafta, produktet e naftës dhe produktet e ngjashme	77 198
	Gaz, natyror dhe industrial	2 822
	Energjia elektrike	28 474
	Vajra, yndyrna dhe shtazore të kafshëve dhe perimeve	8 650
	yndyra e kafshëve dhe vaji	4
	Vajra dhe yndyrna të ngurta bimore, të papërpunuara, të rafinuara ose të pjesshme	7 728

Shkëmbimii mallrave nga sektorët e mallrave dhe seksionet 2018, të dhënat cumulative nga Enti Statistikor i Maqedonisë - <http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat>

		Eksporti
		Në dollar
	yndyrna dhe vajra shtazore dhe vegjetale të përpunuara; Dyllii kafshëve ose i bimëve	919
	Produkte kimike dhe të ngjashme;	1 526 987
	Kimikatat organike	1 510
	Produkte kimike inorganike	8 067
	Produkte ngjyrosjeje dhe ngjyrosje	14 271
	Produkte mjekësore dhe farmaceutike	93 184
	Vajra esenciale, produkte rrëshira dhe parfumeri; përgatitjet për tualet, preparatet për pastrim dhe lustrim	15 198
	Plehra artificiale (me përjashtim të grupit 272)	564
	Plastika në formë primare	17 328
	Plastika në forma të tjera	51 449
	Substancat dhe produktet kimike,	1 325 417
	Produktet e klasifikuara sipas materialit	900 532
	Lëkurë, prodhime prej lëkure, etj. dhe leshi përpunohet	2 973
	Produkte të gomës,	11 688
	Tapa dhe produktet e drurit (me përjashtim të mobilieve)	6 268
	Letër, karton dhe produkte prej celulozë, letre ose kartoni	17 480
	Fije, pëlhura dhe produkte tekstili, dhe produkte të ngjashme	87 547
	Produktet e mineraleve jo metalike, n.	66 898

Shkëmbimii mallrave nga sektorët e mallrave dhe seksionet 2018, të dhënat cumulative nga Enti Statistikor i Maqedonisë - <http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat>

		Eksporti
		Në dollar
	Hekuri dhe çeliku	593 359
	Metale me ngjyra	11 229
	Produkte metalike, B.Sc.	103 090
	Makineri dhe pajisje transporti	2 012 821
	Makinat e shtytjes dhe pajisjet	2 720
	Industritë e specializuara të makinerive	17 115
	Makineritë e përpunimit të metaleve	1 607
	Makineri dhe pajisje industriale për përdorim të përgjithshëm, dhe pjesët e tyre, n.	696 232
	Makinat dhe makinat e zyrave për AOP	3 943
	Aparatet dhe pajisjet e telekomunikacionit; aparate dhe pajisje për regjistrimin dhe riprodhimin e zërit	20 620
	Makinat, aparatet dhe pajisjet elektrike, p.sh. dhe pjesët e tyre elektrike (duke përfshirë pjesët jo elektrike të pajisjeve elektrike shtëpiake, bp)	917 152
	Automjetet rrugore (përfshirë mjetet me ajër të pasagjerëve)	337 223
	Pajisje të tjera të transportit	16 209
	produkte të ndryshme të gatshme	883 637
	Ndërtesa të parafabrikuara; pajisje sanitare; instalime dhe pajisje për ngrohje dhe ndriçim,	2 126
	Mobilime dhe pjesët e tyre; bedding, dyshekë, transportuesit dyshek, jastekë dhe kështu me radhë. produkte të mbushura	268 291
	Artikuj udhëtimi, çanta dhe të ngjashme.	1 762

Shkëmbimii mallrave nga sektorët e mallrave dhe seksionet 2018, të dhënat cumulative nga Enti Statistikor i Maqedonisë - <http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat>

		Eksporti
		Në dollar
	Veshmbathje dhe aksesorë veshjesh	490 380
	Këpucë	54 751
	Instrumente dhe aparate profesionale, shkencore dhe të kontrollit,	13 397
	Aparat fotografik, pajisjet dhe materialet e ricikluara; produkte optike; shikon dhe watches	2 323
	Produkte të ndryshme të përfunduara, BC	50 607
	Mallrat dhe transaksionet e paklasifikuara në vende të tjera në totalin e SITC	6 025
	Ari jo monetar (përveç xeherit dhe koncentreve të arit)	1 829

Nga ana tjetër, sipas "Worldstopexports", liderë botërore në eksportin e verës janë Franca, Italia, Spanja, Australia dhe Kili me realizim nga dy deri në 10,3 miliardë dollarë, ndërsa importues më të mëdhenj janë SHBA-ja, Britania e Madhe, Gjermania, Kina dhe Kanadaja, me import të realizuar nga 1,9 deri në 6,2 miliardë dollarë⁷.

Vitin e kaluar vendi ka eksportuar domate në vlerë prej 17,1 milionë dollarë që është 0,2 prej eksportit botëror, ndërsa eksportii shalqirit ka arritur 2,9 milionë apo, gjithashtu, 0,2 për qind prej eksportit botëror.

Për importin e domateve Maqedonia është radhitur në pozitën e 63-të me sasi të importuara në vlerë prej 2,9 milionë dollarësh që është për 0,03 për qind prej importit në korniza botërore.

Sipas "Worldstopexports", liderë botërorë në eksportin e domateve janë Holanda, Meksika, Spanja, Maroku dhe Kanadaja me 416 milionë deri në dy miliardë dollarë të realizuara, ndërsa në eksportin e shalqirit me 81,6 milionë dollarë deri në 364,6 milionë të realizuara janë Spanja, Meksika, SHBA-ja, Holanda dhe Italia.

⁷<http://www.worldstopexports.com/category/countries/>

Importuesit më të mëdhenj, nga ana tjetër, të domateve janë SHBA-ja, Gjermania, Franca, Britania e Madhe dhe Rusia me import të realizuar prej 558,7 milionë dollarësh deri në 2,3 miliardë.⁸

1.2 Faktorët kryesorë të gritjes dhe stabilizimit të ekonomisë së një shteti

Ruchir Sharma 2002, në librin e tij “Ngritja dhe Rënia e Shteteve” liston dhjetë faktorë të tjerë të cilët ndikojnë në ngritjen apo rënien ekonomike të shteteve. Sharma është investitor i angazhuar në Morgan Stanley, kompani multinacionale financiare, dhe studiues i ekonomive në zhvillim. Duke analizuar të dhënat për 130 shtete, për një periudhë kohore 60 vjeçare, ai arrin në një model ekonomik, ku analizimii shteteve në bazë të këtyre dhjetë kriterëve kryesorë mund të përcaktojë kahjen ekonomike të një shteti në pesë deri dhjetë vitet e ardhshme.

1. A po rritet apo po zvogëlohet fuqia punëtore, dhe sii trajton shoqëria gratë?

Sipas modelit të analizës së propozuar nga Sharma, vendet të cilat kanë pasur një hov të zhvillimit ekonomik kanë pasur njëkohësisht edhe rritje të forcës punëtore. Sipas tij, “asnjëherë në histori nuk ka pasur rritje ekonomike pa rritje të popullsisë”. Sipas kësaj, nevojitet të ketë një rritje të popullsisë, sidomos asaj në moshë të punës, prej së paku 2% në vit. Për të kuptuar se cilat vende kanë problem më të madh me plakjen e popullsisë, Sharma propozon që të krahasohet numrii popullsisë në moshë pune, 15 deri 64 vjeç, me ata që janë nën 15 dhe mbi 65 vjeç. Nëse popullsia mbi 65 vjeç është në rritje, atëherë vendi është duke u përballur me problemin e humbjes së forcës punëtore, në pagesën e pensioneëve. Për këta arsye, shumë vende të botës kanë filluar të shqyrtojnë mundësinë e rritjes së pragut të pensionimit, apo edhe pranimin e më shumë emigrantëve, ashtu siç po vepron aktualisht Gjermania.

Përveç popullsisë në moshë pune, zhvillimi ekonomik i një vendi varet edhe nga ajo se sa u jep hapësirë grave në tregun e punës. Vetëm duke zvogëluar diferencën në punësim në mes të të dy gjinive vendet mund të rrisin GDP-në, 9% (Siç është parë në Brazil) dhe 34% (Në Egjipt) brenda një periudhe dhjetë vjeçare.

2. Kush qeveris me vendin dhe për sa kohë?

Sipas analizës së Sharmas, vendi ka më shumë mundësi të zhvillohet ekonomikisht në vitet e para të qeverisjes nga një lider i ri politik, i cili ka mbështetje të gjerë popullore dhe qeveris në

⁸ Po aty

mënyrë demokratike. Sipas kësaj rregulle, reformat më të mëdha ndodhin në mandatin e parë, vazhdojnë në një intensitet të ulët në mandatin e dytë, dhe nuk lëvizin fare në mandatin e tretë apo më shumë. Përfundim nga ky rregull paraqet vetëm Singapori nën udhëheqjen e Lee Kuan Yew. Të dhënat tregojnë se tregjet i besojnë më shumë një lideri politik në 41 muajt e parë të qeverisjes së tij, pas kësaj periudhe, tregjet e nuhasin vdekjen e ngadalshme të reformave.

3. Si e fitojnë pasurinë njerëzit më të pasur të vendit?

Sipas Sharmas, ekzistojnë milionerë e miliarderë të mirë dhe të këqij. Miliarderë e milionerë të mirë janë ata që arrijnë pasurinë e tyre përmes ndërmarrësisë, të cilët punësojnë një numër të madh njerëzish dhe prodhojnë produkte të cilat përdoren nga konsumatorët. Në këtë mes hyjnë inovacionet teknologjike, showbizi, farmaceutika, tregtia elektronike, etj. Milioner e miliarder të këqij janë ata të cilët pasurinë e tyre e krijojnë përmes privatizimit të burimeve natyrore të vendit, përmes kontratave me qeverinë apo lidhjeve politike. Në mesin e industrive të këqija hyjnë: bixhozi, ndërtimtaria, industritë nxjerrëse si, nafta, qymyri, ari, gazi, etj. Nëse një vend ka më shumë milioner dhe miliarder të këqij, pabarazia shoqërore rritet dhe popullsia fillon të dyshojë në ndershmërinë e biznesmenëve. Milionerët e miliarderët e këqij krijojnë pasurinë duke dëmtuar interesat e përgjithshme të shoqërisë; kurse milionerët dhe miliarderët e mirë krijojnë pasuri duke krijuar njëkohësisht vende të punës dhe të mira të gjithëmbarshme shoqërore.

4. Sa përzihet shteti në ekonomi?

Sipas Sharmas, aq më pak që shteti përzihet në ekonomi, aq më të mëdha janë gjasat për rritje ekonomike. Përzierja e shtetit në ekonomi është e dëmshme veçanërisht në vendet e korruptuara, liderët e të cilave përdorin paratë publike për të investuar në ato projekte të cilat kanë përfitim afatshkurtër, me qëllim që të krijojnë një përshtypje të mirë për veten e tyre. Po ashtu, shtetet duhet të përzgjedhin me kujdes projektet në të cilat do të investojnë, me qëllim që të arrijnë efektin më të madh ekonomik me shpenzimet sa më të vogla.

4. A ndodhet vendi në pozitë të rëndësishme gjeografike?

Çdo vend i cili ka për synim që të rris zhvillimin ekonomik përmes eksportit, duhet të kujdeset që të jetë sa më afër rrugëve tregtare që ndërlidhin konsumatorët e pasur me furnizuesit më të përshtatshëm. “Mrekullitë aziatike”, siç cilësohen shpesh Japonia, Korea e Jugut, Taivani, Singapori, kanë përjetuar rritje ekonomike falë edhe faktorit gjeografik. Por vetëm pozita

gjeografike nuk është e mjaftueshme për të gjeneruar zhvillim ekonomik, nëse shtetet nuk marrin hapa që pozitën e tyre gjeografike ta materializojnë përmes ndërtimit të infrastrukturës e cila lehtëson tregtinë. Por, rëndësia e pozitës gjeografike mund të ndryshojë me kohë.

6. Investimet, eksportet po bien apo rriten?

Një faktor tjetër i cili ndikon në rritjen apo rënien ekonomike të shteteve është edhe shkalla e investime në krahasim me GDP. Dy lloje të ndryshme të shpenzimeve ndikojnë në ekonomi: shpenzimet e konsumit dhe ato investive. Investimet janë ato që ndikojnë në krijimin e bizneseve të reja dhe vende të reja të punës. Secili shtet i cili synon rritje të shpejtë ekonomike, duhet të ketë investime të barazvlefshme me 25% deri 35% të GDP. Këtu nuk bëhet fjalë vetëm për investimet shtetërore, por edhe investimet e sektorit privat dhe investimet e huaja. E rëndësishme është se edhe ku bëhen ato investime. Investimet më të mira apo me efekt më të madh ekonomik janë ato që përqendrohen në industri prodhuese, në teknologji dhe infrastrukturë, duke përfshirë rrugët, rrjetet energjetike dhe ato të furnizimit me ujë. Investimet më të këqija janë ato në sektorin e pronave, ngase kanë efekt shumë të vogël në zhvillim. Shtetet nuk mund të zhvillohen vetëm duke u fokusuar në ekonominë e shërbimeve. Zhvillimi më i hovshëm i një vendi vjen kur prodhimi merr hov. Aty ku ka prodhim, industria e shërbimeve lulëzon natyrshëm.

7. A është inflacioni lartë apo i ulët?

Inflacioni është një ndër faktorët më të rrezikshëm që mund t'i ndodh ekonomisë së një shteti. Rritja e çmimeve të ushqimeve ka sjellë pakënaqësitë dhe revolucionet dhe shembjet më të mëdha të ekonomive përgjatë historisë. Ka të tillë që mendojnë se që nga Revolucioni Francez e deri tek Pranvera Arabe, rritja e çmimeve të ushqimit ka qenë faktori kryesor i fillimit të revolucioneve. Vendet që përjetojnë zhvillim të hovshëm ekonomik, pashmangshëm do të pësojnë edhe inflacion të çmimeve, por sipas Sharmas duhet pasur kujdes që inflacioni të jetë gradual dhe të mos ketë rritje të menjëhershme.

8. A është shtrenjtë apo lirë të jetosh?

Një mënyrë tjetër për të analizuar gjendjen ekonomike të shteteve është edhe ajo se a është shtrenjtë apo lirë të përballosh kushtet e jetesës. Nëse një vend ka valutë të vlerësuar lartë, do të inkurajojë edhe vendasit por edhe të huajt që të shpenzojnë paratë jashtë vendit. Nëse konsumatorët ndjehen se valuta e një vendi është e lirë, atëherë kjo mund ti sjellë më shumë të ardhura ekonomisë

përmes turizmit, eksporteve dhe kanaleve tjera. Edhe pse ekziston një bindje e gjerë e popullsisë se sa më e fortë valuta, aq më i zhvilluar ai vend, të dhënat e Sharmas tregojnë se jeta e shtrenjtë në një vend të varfër apo në zhvillim ndikon në humbjen e turistëve dhe largimin e parasë jashtë vendit.

9. A po rritet borxhi shtetit më shumë se sa ekonomia?

Në bazë të analizës së Ruchir Sharma, secili vend në botë i cili për pesë vite radhazi e mban nivelin e borxhit publik në shkallën 40% e sipër të GDP, është i destinuar që të pësojë krizë financiare. Por, jo gjithmonë borxhi publik është diçka e keqe. Nëse mbahet nën kontroll, borxhi publik mund të ndihmojë rritjen ekonomike. Po ashtu, është me rëndësi së për çfarë hyhet në borxhe. Nëse shtetet hyjnë në borxh për të financuar konsumin e brendshëm apo skemat sociale, atëherë edhe nivelet më të ulëta të borxhit janë të dëmshme.

10. Si portretizohet një vend nga opinion krijuesit dhe mediat?

Sa më shumë që të zgjat rritja ekonomike e një vendi, aq më shumë ai vend portretizohet pozitivisht në raporte dhe media ndërkombëtare. Por, sipas Sharmas, mediat janë të ngadalshme që të zbulojnë trendet e rritjes. Sipas tij, në momentin që një shtet portretizohet në ballinën e revistave Time apo Newsweek, ky është sinjal se ai shtet është në pikun e rritjes ekonomike dhe ajo çfarë do pasojë është vetëm rënia. Mediat ndërkombëtare kanë tendencë të raportojnë gjerësisht për krizën që ndodh në një vend. Pas kalimit të krizës, mediat harrojnë zhvillimet në atë vend. E zakonisht, vetëm pas krizave fillon rritja e madhe ekonomike.

1.3 Lidhja e ndërsjelltë tregti - investime të huaja direkte - eksport

Mund të thuhet se, ekziston një literaturë e gjerë dhe gjithëpërfshirëse lidhur me impaktin e investimeve të huaja direkte në tregti. Sipas Mundell (1957), për një kohë të gjatë, supozohej se investimet e huaja zëvendësonin tregtinë. Kjo hipotezë u sfidua nga Agmon (1979) dhe më pas, një numër i madh studimesh filluan të prezantonin hipotezën se, investimet e huaja dhe tregtia mund të kosiderohen dhe si plotësuese të njëra-tjetrës.

Në vazhdim, studiues të tjerë si Ethier (1994, 1996) dhe Markusen (1995, 1998) dhanë kontribute të mëtejshme në këtë fushë. Megjithatë, kohët e fundit, janë zhvilluar studime të reja të cilat kanë eksploruar më tej lidhjen midis investimeve të huaja direkte dhe tregtisë (Markusen

dhe Maskus, 2001) duke nxjerrë në pah evidenca të reja. Studimet mbi tregtinë dhe investimet e huaja direkte, të përmendura më sipër, mund të ndahen në 3 kategori kryesore:

Së pari: studime të cilat argumentojnë se përcaktuesit e investimeve të huaja direkte dhe tregtisë janë të ngjashëm, dhe si rrjedhim çfarë përcakton tregtinë, përcakton dhe flukset e IHD-ve (Ekholm, 2002).

Së dyti: studime që kanë pasur si qëllim vlerësime ekonometrike, në të cilat investimet e huaja, eksportet dhe importet janë të përcaktuara njëkohësisht. Në këto studime, të tre këta variabla cilësohen si variabla endogjenë dhe si rrjedhim, bashkëveprimii tyre duhet të merret në konsideratë (Hejazi dhe Safarian, 2003).

Së treti: studime të cilat kanë si qëllim vlerësimin e impaktit të marrëveshjeve të tregtisë së lirë në flukset e investimeve të huaja direkte (Binh dhe Haughton, 2002; Worth, 2002). Banga (2004) tregoi se marrëveshjet tregtare rajonale si ASEAN dhe APEC, mund të ndikonin në flukset e IHD-ve në rajon, duke argumentuar se, sa më e lartë të jetë shkalla e integritit rajonal aq më të ulta janë risqet që shoqërojnë këto investime. Tashmë është mëse e qartë dhe e pamundur për t'u vënë në dyshim se, investimet e huaja direkte dhe tregtia janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën.

Në shumë studime, siç u tha edhe më sipër, është argumentuar se IHD-të mund të konsiderohen si zëvendësuese të tregtisë, ose si plotësuese të saj (në rastin e tregtisë brenda degës). Megjithatë, lidhja midis IHD-ve dhe tregtisë është bërë akoma dhe më komplekse, nën regjimin e Organizatës Botërore të Tregtisë. Nën ndikimin e këtij regjimi, vende të ndryshme në zhvillim, kanë nxitur liberalizimin e importeve dhe kanë negociuar marrëveshje tregtare, të cilat kanë ulur në mënyrë drastike kostot e të bërit tregti, madje dhe duke inkurajuar këtë të fundit.

Me rritjen e volumeve tregtare, vëmendja e politik-bërësve në vendet në zhvillim, është zhvendosur nga çështja nëse IHD-të shkaktojnë tregti, në çështjen, nëse tregtia mund të shkaktojë rritje të flukseve hyrëse të IHD-ve dhe ç'lloj tregtie mund ta shkaktojë këtë. Përgjigjet e këtyre pyetjeve janë bërë akoma dhe më të rëndësishme, në kushtet e formave të ndryshme të tregtisë bilaterale dhe multilaterale, në të cilat vendet në zhvillim janë angazhuar kohët e fundit. Pavarësisht rëndësisë së kësaj çështjeje, veçanërisht për vendet në zhvillim, mund të thuhet se ekziston një literaturë e varfër lidhur me impaktin e tregtisë në flukset e IHD-ve.

Disa studime dëshmojnë se IHD-të janë përdorur për të mbrojtur tregjet me bazë eksporti (Grosse dhe Trevino, 1996), ndërsa punime të tjera kanë sugjeruar se janë IHD-të të cilat ndjekin eksportet (Eaton dhe Tamura, 1994), (në veçanti, IHD në Shtetet e Bashkuara).

Në literaturë ekzistojnë shumë studime të cilat dëshmojnë për ndikimin e investimeve të huaja direkte në tregti, ndërsa për vlerësimin empirik të impaktit të tregtisë në flukset e investimeve të huaja mbetet ende shumë për t'u bërë. Forma të ndryshme të tregtisë mund të influencojnë flukset e investimeve të huaja në mënyra të ndryshme. Për shembull, mund të priten impakte të ndryshme të ndikimit të tregtisë të shoqëruar me integrimin vertikal ndërkombëtar, dhe të tregtisë brendadegësore të tipit vertikal ose horizontale, në flukset e investimeve të huaja në vendet në zhvillim.

Tregtia e shoqëruar me integrimin vertikal mund të shkaktojë rritje të investimeve të huaja direkte, nëpërmjet sigurimit të nxitjeve për uljen e kostos, ndërsa tregtia brendadegësore mund të dekurajojë investimet e huaja që kanë si kusht ekonominë e shkallës. Nga sa u tha më sipër, është evident fakti, që impaktii formave të ndryshme të tregtisë në flukset e IHD-ve në vendet në zhvillim, përveçse një fushë e rëndësishme dhe e dobishme studimi për studiuesit, është me rëndësi të veçantë edhe për politikë-bërësit.

1.4 Lidhja e ndërsjellë tregti-punësim me theks tek eksporti

Liberalizimi tregtar, i përkufizuar si një lëvizje drejt tregisë së lirë, nëpërmjet reduktimit të tarifave dhe barrierave të tjera, në përgjithësi perceptohet si forca kryesore drejtuese drejt globalizimit. Intensifikimi i integrit të ekonomisë globale, në dekadat e fundit, dëshmohet qartë nëpërmjet rritjes së shpejtë të flukseve të të mirave dhe shërbimeve përtej kufijve kombëtarë.

Në anën tjetër, kritikë të liberalizimit, e kanë fajësuar këtë të fundit, si burim “sëmundjesh”, të tilla si: papunësia e rritur; pabarazia e pagave në ekonominë e avancuar; mbipërdorimi i punëtorëve në vendet në zhvillim shoqëruar me keqësimin e kushteve dhe standarteve të punës; de-industrializimi dhe marxhinalizimi i vendeve me të ardhura të ulta; varfëria e rritur dhe pabarazia globale; degradimi i mjedisit (Rodriguez and Rodrik, 1999).

Në këtë kontekst, impaktii liberalizimit tregtar në punësim është i një rëndësie të veçantë. Nivelii punësimit është një faktor thelbësor në mirëqënien e përgjithshme e ekonomike, veçanërisht në vendet në zhvillim, ku sistemet e mbrojtjes sociale janë të dobëta. Në veçanti, impaktii liberalizimit tregtar në nivelin dhe strukturën e punësimit, kushtëzon ndikimin në

varfëri, paga dhe shpërndarjen e të ardhurave dhe cilësinë e punësimit. Këta variabla përbëjnë dhe çështjet më kritike në debatet rreth liberalizimit tregtar.

Në kuadrin e liberalizimit tregtar, në jetën e përditshme, riorganizimii faktorëve të prodhimit, i nevojshëm për shfrytëzimin e avantazheve krahasuese, mund të çojë në zhvillime në tregun e punës si negative ashtu dhe pozitive të tilla si: mbyllje të kompanive, humbje të vendeve të punës në disa sektorë të ekonomisë; por edhe ngritje të firmave të reja, rritje në prodhim, dhe vende të reja pune në sektorë të tjerë të ekonomisë.

Pra, liberalizimi tregtar është i shoqëruar me reduktim të vendeve të punës nga njëra anë, por edhe me krijim të tyre nga ana tjetër. Nëse rezultati neto, në periudhën afatshkurtër, në efektet e punësimit, është pozitiv apo negativ, varet kryesisht nga faktorët specifikë të vendit, të tilla si: funksionimii tregut të punës. Ndërsa në periudhën afatgjatë, rritja dhe përfitimet në eficiencë, të shkaktuara nga liberalizimi tregtar, pritet të çojnë në efekte pozitive punësimi, si në termat e sasisë ashtu dhe të cilësisë së punës ose dhe të të dyjave së bashku [Anderson dhe Martin (2006), Bouwt (2005), Decreux dhe Fontagné (2006) dhe Polaski (2006)].

Literatura teorike ofron vëzhgime interesante lidhur me reduktimin dhe krijimin e vendeve të punës, si pasojë e liberalizimit tregtar, duke ilustruar se si karakteristikat e vendit, duke përfshirë dhe politikat e tregut të punës, mund të ndikojnë përkohësisht si dhe në mënyrë permanente në punësim, si në nivel sektori apo dhe më gjerë, në nivel vendi. Shpeshherë, për shkak të problemeve me të dhënat dhe metodologjitë, ka qenë i vështirë sigurimii evidencave të forta empirike, për impaktin e liberalizimit tregtar në politikat e brendshme të punësimit dhe rritjen ekonomike (Piermartini dhe The, 2005).

Siç u tha edhe më sipër, është e vështirë të bësh përgjithësime lidhur me marrëdhënien tregti – punësim. Mund të thuhet se, ekziston një literaturë ende në zhvillim, e cila e vë theksin në rëndësinë e faktorëve të rinj, që influencojnë marrëdhënien tregti – punësim, veçanërisht për vendet në zhvillim, të tilla si: impaktii investimeve të huaja direkte; natyra e tregtisë; rolii ndryshimeve teknologjike; impaktii rritjes së hapjes tregtare në elasticitetin e kërkesës për punë. Karakteristikat në kushtet e çdo vendi, natyra e institucioneve dhe mënyra se si implementohen politikat tregtare, janë faktorë të tjerë, të cilët ndikojnë në relacionin tregti-punësim. Nga sa u tha më sipër, procesii globalizimit mund të jetë pozitiv për pjesën më të madhe të punëtorëve në vendet e zhvilluara industriale dhe ato në zhvillim, ndërkohë që për një pjesë tjetër jo. Prandaj efektet shpërndarëse të tij nuk duhen injoruar. Politikat tregtare dhe politikat sociale duhet të

bashkëveprojnë me njëra-tjetrën dhe sa më e madhe koherenca e tyre në këto dy këndvështrime, aq më i madh do të jetë impakti pozitiv në efektet e rritjes të reformave tregtare dhe si rrjedhim, në përmirësimin e cilësisë së punës në botë. Përsa i përket situatës së punësimit në nivel global, mund të thuhet se forca punëtore globale në 2005 numëronte 2.88 billion individë, nga të cilët 0.55 billion i përkisnin vendeve të OECD-së (OECD, 2005).

Meqë tregtia dhe investimet e huaja direkte janë duke luajtur një rol gjithnjë dhe në rritje në ekonominë globale, ndikimii tyre në tregjet e punës tashmë është i drejtpërdrejtë. Kjo vlen si për vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim. Mbi 70 % e punësimit total, është i përqëndruar në sektorin e shërbimeve. Pavarësisht rritjes së kohëve të fundit në këtë sektor, pjesa më e madhe e tij konsiston në aktivitetin e të mirave jo të tregtueshme.

Së fundmi, veçanërisht në vendet me të ardhura të ulta, pjesa më e madhe e punësimit është e përqëndruar në bujqësi dhe ekonominë informale. Për pjesën më të madhe të popullsisë aktive për punë në rang botëror, mund të thuhet se, është ende niveli zhvillimit dhe performancës së ekonomisë së brendshme në të cilën ata punojnë, faktori që përcakton vendin e tyre të punës dhe prespektivën lidhur me të ardhurat. Një tjetër indikator makroekonomik i lidhur ngushtë me tregtinë e jashtme dhe proceset liberalizuese që kanë shoqëruar atë, është edhe kursii këmbimit. Shkalla dhe madhësia e kësaj varësie është e ndryshme në vende të ndryshme ose në të njëjtin vend të zhvendosur në kohë, në përputhje me llojet e politikave valutore dhe zgjedhjet mes regjimeve të kurseve të ndryshme të këmbimit.

1.5 Eksporti dhe Tregtia ndërkombëtare

Shoqëria e mbështet zhvillimin e vet në ndarjen shoqërore të punës, e cila fillon që më lindjen e familjes, vazhdon në koloni, në shtet dhe në kohën bashkëkohore të krijuar në epokën e globalizimit. Tregtia ka qenë mjeti kryesor përmes së cilës filluan jo vetëm komunikimet në mes njerëzve por edhe shkëmbimii të mirave dhe mallrave ndërmjet këtyre njerëzve, ku të gjitha realizoheshin përmes mekanizmave të njohura si treg.

Me krijimin e bashkësive të mëdha dhe më vonë me lindjen e shteteve u paraqit nevoja e këmbimit të produkteve dhe shërbimeve në mes të shteteve . Pra, lindi nevoja për krijimin e mekanizmave të reja që tregtia të marrë përmasat e shkëmbimeve ndërkombëtare. Krijimii këtyre mekanizmave të reja bëri që sot ekonomia ndërkombëtare të konsiderohet si një nga komponentët kryesorë të ekonomisë botërore.

Tregtia ndërkombëtare mundëson dhe nxiton ndarjen ndërkombëtare të punës ndërsa zhvillimi i tregtisë së jashtme varet nga ndarja ndërkombëtare e punës. Ndarja e punës dhe specializimi në prodhimin e produkteve të caktuara në aspektin ndërkombëtar kushtëzon lidhshmërinë dhe ndërvarësinë e ndërsjellë ekonomike të vendeve. Pra, që tregtia të arrijë përmasat ndërkombëtare është dashur një zhvillim gradual përgjatë shekujve çka solli një zhvillim ekonomik, social, politik dhe kulturor duke arritur një nivel të lartë dekadat e fundit si rezultat i procesit të industrializimit, transportit të avancuar, globalizimit dhe lindjen e korporatave multinacionale.

Tregtia ndërkombëtare është rregulluar tradicionalisht përmes marrëveshjeve bilaterale, por pas luftës së dytë botërore filluan të nënshkruhen edhe traktate multilaterale, me qëllim të krijimit të një strukture globale që rregullonte tregtinë ndërkombëtare përmes institucioneve ndërkombëtare.

Qysh pas Luftës së dytë Botërore me 1945 mendohej që fluksi i investimeve dhe i tregtisë ndërkombëtare mund të ishin qelsi i lulzimit mbarëbotror. Pas shumë negociatave në Londër, Gjenevë, New York arriten deri në një marrëveshje në mars të viti 1948 në Havane të Kubës me nënshkrimin e kartës së Havanës për ITO (International Trade Organization). Aty përfaqësoheshin marrëveshje midis 53 vendeve, kjo organizatë botërore e tregtisë parashikohej të merret me politikat e tregtisë ndërkombëtare, marrëveshjet për mallrat, punëzimin, rindërtimin dhe zhvillimin ekonomik dhe ngritjen e një agjensioni të ri të Kombeve të Bashkuara për të administruar gjithçka. Mirëpo ngashume kombe karta nuk u ratifikua për shkak të dështimit të sovranitetit kombëtar. GATT (General agreement on trade and tariffs) – ka qenë organizimi më i suksesshëm ndërkombëtar pas L.I.B, ka qenë trupi kryesor për negociatat multilaterale mes vendeve të ndryshme me qëllim të heqjes së barrierave tregtare dhe në krijimin e mekanizmave për të thjeshtuar tregtinë ndërkombëtare. Ka qenë e vendosur në Gjenevë, sekretariatii GATT-it drejtonte punën e tij nëpërmjet përfaqësuesve të vendeve antare. Negociatat speciale si Raundii Tokios, Raundi Kenedi diskutuan për reduktimin e barrierave tregtare, ndërsa në Raundin tjetër të Uruguajt u përqendruan tregtinë e shërbimeve, mbrojtjen e të drejtave të pasurisë intelektuale si dhe për reduktimin e barrierave tregtare. WTO (world trade organization) e ka zëvendësuar GATT-in që tash përfaqëson shumicën e vendeve të globit, dhe ka zgjeruar veprimtarinë e saj shumë më tej sesa marrëveshjet për tregti dhe tarifa. FMN (fondi monetar ndërkombëtar) – një institucion tjetër ndërkombëtar, themeluar në vitin 1943 që ta siguroj

stabilitetin e sistemit monetar nderkombetar dhe qe tesiguroj kurset fikse te kembimit midis vendeve, poashtu huazonte te holla per tindihmuar vendeve te shkatrruara nga lufta dyte botrore. Banka Botrore ka pasur ndikim te madh nderkombetare, formuar ne vitin 1944 perte ndihumar vendet qe vuanin nga shkattrimet e luftes, si dhe me vone e mori detyren perte ndihmuar zhvillimin botror. Kur vendet here pas here kishin emergjenca, ajo i kadhene si nje infuzion thene figurativish per te stimuluar ngritjen ekonomike ne ato vende⁹.

Tregtia ndërkombëtare ka pësuar ndryshime të mëdha edhe falë globalizimit si rezultat i ndryshimeve ekonomike, sociale, teknologjike, kulturore dhe politike, të cilat kanë krijuar ndërvarësi ndërmjet shteteve, integrim dhe bashkëpunim ndërmjet njerëzve dhe kompanive të ndryshme. Po të marrim parasysh tregjet e lindjes dhe të perëndimit para viteve '90 nuk rezultonte një treg global pavarësisht përpjekjeve, ndërsa sot besimi tek demokracia dhe ekonomia e tregut janë parimet bazë të organizimit të jetës. Para procesit të globalizmit SHBA dominonte ekonominë globale kurse sot ShBA-të zotërojnë vetëm 25 % të tregut sepse mundësia e shteteve të tjera për industrializim është rritur falë globalizmit. Kjo është arsyeja që shumë analistë konsiderojnë se motorët kryesorë që çuan botën drejt globalizmit ishte tregtia ndërkombëtare dhe zhvillimii hovshëm i teknologjisë.

Kështu evoluimii tregtisë ndërkombëtare solli lidhjet ndërmjet shteteve në epokën e globalizimit. Epoka e sotme e globalizimit paraqet vëllimet e përgjithshme dhe ndryshimet e mëdha dhe të shpejta në të gjitha sferat e jetës.

Rolii shteteve në nivelin rajonal dhe global po ndryshon. Organizatat ndërkombëtare, korporatat multinacionale dhe organizatat joqeveritare kanë hyrë në skenë si aktorë të rëndësishëm në politikën botërore. Vendimet dhe rregullat e tyre ndikojnë në politikat e shteteve dhe në jetët e miliona njerëzve. Në këtë kohë është duke u zhvilluar një proces ku shtetet e pavarura, nëpërmjet kompanive multinacionale dhe institucioneve ndërmjetësuese financiare, janë duke u ndërlidhur njëra me tjetrën. Kjo ndërlidhje solli deri te procesii globalizimit të përgjithshëm, veçanërisht deri te globalizimii ekonomisë botërore.

Ekonomia globale ka përparësi të shumta, në radhë të parë për bizneset. Mënjanimii barrierave tregtare botërore u mundëson kompanive të përfitojnë nga fuqia më e madhe dhe më e lirë punëtore dhe njëkohësisht nga zhvillimii hovshëm tekniko-teknologjik. Në epokën e

⁹<https://www.scribd.com/doc/81438428/Biznesi-Nderkomb1etar>

globalizimit bizneset e vogla kanë terren më të përshtatshëm për t'u zgjeruar globalisht më shpejtë, kanë më shumë zgjedhje në rekrutimin e fuqisë punëtore dhe në fund mundësinë për të shitur produktet e tyre në një treg më të gjërë. Kjo tregon se në epokën e globalizimit është e vështirë të paramendohet funksionimi i një ekonomie të izoluar nga tregu ndërkombëtar i mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe fuqisë punëtore.

Ekonomia globale ka efekte pozitive edhe në aspektin politik ngase promovon bashkëpunimin ndërkombëtar dhe ndikon dukshëm në ruajtjen e paqes. Nëse shtetet gjatë gjithë historisë vazhduan të zhvilloheshin në aspektin ekonomik duke zhvilluar tregti të ndërsjellë, atëherë stabiliteti politik dhe paqja është e domosdoshme për një zhvillim normal të tregtisë. Ekonomia globale vazhdon të zgjerohet dhe reduktimi i barrierave tregtare do të krijojë mundësi të reja dhe të ndryshme nga ato me të cilat përballen bizneset sot.

1.6 Avantazhet dhe kostot e Investimeve të huaja direkte (IHD)

Avantazhet kryesore të IHD-së për shtetin, burojnë nga efektet e transferit të burimeve, efektet e punësimit, efektet e bilancit të pagesave si dhe efektet e rritjes dhe konkurrencës ekonomike.

Investimet e huaja kontribuojnë pozitivisht në ekonominë e shtetit duke furnizuar kapital, teknologji si dhe burime menaxheriale të cilat përndryshe nuk do të ishin të disponueshme, dhe si rezultat nuk do të kishte as rritje ekonomike.

Sa i përket kapitalit, shumë korporata multinacionale në sajë të madhësisë dhe fuqisë financiare, kanë qasje në burimet financiare gjithë të cilën firmat nikoqire (të huaja) nuk e kanë. Burime të brendshme të kompanisë kanë qasje te këto fonde, ose për shkak të reputacionit të tyre, apo kompanitë e mëdha multinacionale mund ta kenë më të lehtë të huazojnë fonde nga tregjet e kapitaleve se sa firmat nikoqire.

Sa i përket teknologjisë, teknologjia stimulon zhvillim ekonomik dhe industrial. Teknologjia mund të mer 2 forma, që të dyja janë të vlefshme. Teknologjia mund të inkorporohet në procesin e prodhimit (psh. teknologjia për zbulimin, nxjerrjen dhe përpunimin e naftës) ose mund të inkorporohet në një produkt (psh kompjuter personal). Megjithatë, shumë shtete kanë mungesë të burimeve hulumtuese dhe zhvilluese si dhe aftësi të nevojshme për të zhvilluar produkt vendas dhe për të procesuar teknologji. Kjo vjen në pah tek kombet më pak të zhvilluara.

Këta të fundit, për të stimuluar rritje ekonomike, duhet të mbështeten tek shtetet të industrializuara për teknologjinë që kërkohet, dhe eksporti mund të mundësojë diçka të këtillë.

Hulumtimet e përkrahin idenë se korporatat multinacionale shpesh transferojnë teknologji të rëndësishme kur investojnë në një shtet të huaj. Për shembull, një studim i eksporteve në Suedi, arriti në përfundim se kompanitë e huaja rritën si faktorin e punës ashtu edhe atë të produktivitetit total që ata kishin siguruar, duke sugjeruar kështu se transfere të rëndësishme teknologjike kishin ndodhur (teknologjia zakonisht rrit produktivitetin). Gjithashtu një studim i eksporteve të realizuar nga ana e Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik zbuloi se investitorët e huaj investonin sasi të konsiderueshme kapitalesh në Hulumtim dhe Zbulim në shtetet që ata kishin investuar, duke sugjeruar se ata jo vetëm që transferonin teknologji te këto shtete, por ata gjithashtu e avanconin teknologjinë ekzistuese apo krijonin teknologji të reja në këto shtete.

Menaxherët e huaj të trajnuar me teknikat më të fundit menaxheriale mund të ndihmojnë në përmirësimin e efikasitetit e operacioneve në shtet, pa marrë parasysh nëse këto operacione janë të siguruara apo zhvillime Greenfield (Në shumë disiplina një projekt greenfield është ai që nuk ka kufizime të imponuara nga puna e mëparshme). Mund të ndodhin efekte të dobishme kur personeli lokal të cilët janë të trajnuar për të zënë poste menaxheriale, financiare dhe teknike në filialet e Korporatave Multinacionale, e braktisin kompaninë dhe ndihmojnë të krijohen kompani indigjene (vendase). Dobi të ngjashme mund të ndodhin kur aftësitë e larta menaxheriale të një korporate multinacionale i stimulojnë furnizuesit, distributorët si dhe konkurrentët t'i përmirësojnë aftësitë e veta menaxheriale.

➤ Efektet e punësimit

Një efekt tjetër i dobishëm që pretendohet nga ana e eksportit është punësimi. Me anë të kësaj hapen pozicione pune në një shtet; mundësi e cila përndryshen do të ishte krijuar atje. Efektet e nivelit të eksportit janë edhe direkte edhe indirekte. Efektet direkte shfaqen kur korporata multinacionale punëson numër të madh të qytetarëve nikoqir. Efektet indirekte shfaqen kur krijohen vende pune tek furnizuesit lokal si rezultat i investimit dhe kur krijohen vende pune për shkak të rritjes së shpenzimeve lokale nga punonjësit e Korporatave Multinacionale. Efektet indirekte të punësimit janë shpesh po aq të mëdha, madje në disa raste më të mëdha se efektet direkte. Për shembull: kur Toyota vendosi të hap një fabrikë në Francë në vitin 1997, vlerësimet

sugjeruan se fabrika do të krijonte 2000 vende direkte pune dhe mbase 2000 të tjera për industrinë mbështetëse.

Kritikuesit thonë se jo të gjitha “punësimet e reja” të krijuara nga eksporti paraqesin shtesa neto në punësim. Në rastin e eksporteve nga kompanitë e veturave Japoneze në SHBA, disa thonë se punësimet nga ky investim kanë qenë më tepër si kompensim për punët e humbura në SHBA të cilët e kanë humbur garën e tregut me konkurentët Japonez. . Si pasojë e efekteve të tilla të zëvendësimit, numri neto i vendeve të reja të punës të krijuara nga eksporti nuk mund të jetë aq i madh sa fillimisht është pretenduar nga Korporata Multinacionale. Çështja e fitimit neto të mundshëm në punësim mund të jetë një pikë e rëndësishme negociuese ndërmjet një Korporate Multinacionale që dëshiron të ndërmarrë eksport dhe qeverisjen nikoqire.

Kur eksportet marrin formën e një blerjeje të një ndërmarrjeje të themeluar në ekonominë nikoqire në krahasim me investimin Greenfield, efektii menjëhershëm mund të jetë zvogëlimi i punësimit pasi që korporata multinacionale përpiqet të ristrukturojë operacionet e njësisë së fituar për të përmirësuar efikasitetin e saj operativ. Megjithatë edhe në raste të këtilla, hulumtimet sugjerojnë që sapo të ketë përfunduar periudha fillestare e ristrukturimit, ndërmarrjet e fituara nga firmat e huaja tentojnë të rrisin bazën e punësimit në një shkallë më të shpejtë sesa rivalët vendas. Për shembull, një studim i Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik zbuloi se ndërmjet viteve 1989 dhe 1996 firmat e huaja krijojnë punësime të reja më shpejtë se homologët e tyre vendas. Në Amerikë, fuqia punëtore e firmave u rrit me 1.4% në vit, krahasuar me 0.8 % në vit për firmat vendase.

Në Britani dhe Francë, fuqia punëtore e firmave të huaja u rrit me 1.7 % në vit, ndërsa punësimi në firmat vendase ranë 2.7 %. Studimii njëjtë zbuloi se firmat e huaja tentonin të paguajnë paga më të larta se sa firmat vendase, që sugjeron se kualiteti i punësimit ishte më i mirë. Një studim tjetër që i referohet eksporteve në Europën Lindore, ekonomitë në tranzicion zbuluan që edhe pse punësimi ra si rezultat i blerjes së ndërmarrjes nga një firmë e huaj, shpesh ndërmarrjet ishin në vështirësi konkurruese dhe ato nuk do të kishin mbijetuar nëse nuk do të ishin blejt. Gjithashtu, pas një periudhe fillestare adptimi dhe shkurtimi, reduktimii punësimit shpesh pasohej me investime të reja. Si rezultat, punësimi ose qëndronte stabil ose rritej.

➤ Efektet e bilancit të pagesave

Efektii eksportit në llogaritë e bilancit të një vendi është një çështje e rëndësishme e politikës për shumicën e qeverive nikoqire. Llogaritë e bilancit të një vendi, ndjekin pagesat dhe faturat nga shteti në shtet. Kuptohet që qeveritë janë të shqetësuara kur vendii tyre po drejton një deficit në llogarinë aktuale të bilancit të pagesave të tyre. Llogaria aktuale ndjek eksportin dhe importin e mallrave dhe shërbimeve. Deficitii llogarisë aktuale, ose deficitit tregtar siç quhet shpesh, vjen në pah kur një vend importon më shumë mallra dhe shërbime se sa që eksporton. Qeveritë zakonisht preferojnë të shohin një tepricë të llogarisë suficite sesa një deficit. Mënyra e vetme në të cilën deficitii llogarisë aktuale mund të mbështetet në një afat të gjatë, bëhet duke iu shitur asete të huajve. Për shembull, Deficitii vazhdueshëm i llogarisë aktuale të SHBA-së që nga viti 1980 është financuar nga një shitje e qëndrueshme e aseteve të SHBA-ve (mallra, obligime, pasuri të paluajtshme dhe korporata të tëra) të huajve. Meqenëse qeveritë kombëtare nuk i pëlqejnë të shohin pasuritë e vendit të tyre të bien në duar të huaja, ato preferojnë që kombii tyre të menaxhojnë një suficit të llogarisë aktuale. Ka 2 mënyra me të cilën eksporti mund ti ndihmojnë një shteti që t'a arrijë këtë qëllim.

Së pari nëse eksportet paraqesin një zëvendësim për importet e mallrave ose shërbimeve, efekti do të ishte përmirësimi i llogarisë aktuale të bilancit të pagesave të shtetit nikoqir. Shumica nga eksporteve të komanive automobilistike Japoneze në SHBA-të dhe Evropë mund të shihen si zëvendësim importi nga Japonia. Kështu që llogari aktuale e bilancit të pagesave të SHBA-ve në njëfarë mënyre është përmirësuar sepse shumë kompani Japoneze tani e furnizojnë tregun e SHBA-ve nga pajisjet prodhuese në SHBA, në krahasim me ato në Japoni. Për aq sa kjo ka zvogëluar nevojën për të financuar një deficit të llogarisë aktuale duke shitur të asete të huajve; shtetet e Bashkuara kanë përfituar në mënyrë të qartë. Një përfitim i dytë potencial vjen kur Koroprata Multinacionale përdor një filialë të huaj për të eksportuar mallra dhe shërbime në vende të tjera. Sipas një raporti të OKB-së, investimet e brendshme nga multinacionalet e huaja kanë qenë një nxitës i madh i rritjes ekonomike si rezultat i eksportit për kombet e zhvilluara dhe ato në zhvillim e sipër gjatë dekadës së fundit. Për shembull, në Kinë eksporti u rrit nga 26 biljon \$ në vitin 1985 në më shumë se 250 biljon \$ në vitin 2001 si dhe 762 biljon \$ në vitin 2005. Pjesa më e madhe e kësaj rritje dramatike eksporti ishte për shkak të pranisë së huaj multinacionale që investuan shumë në Kinë gjatë viteve 1990. Filialet e multinacionaleve

llogaritën 50 % të të gjitha eksporteve nga ai shtet në vitin 2001 nga gjithsej 17 % në vitin 1991. Në telefonat celular për shembull, filialet Kineze të multinacionaleve - kryesisht Nokia, Motorola, Ericsson, dhe Siemens – llogarisnin 95% të eksportit Kinez.

➤ Efekti mbi Konkurrencën dhe Rritjen Ekonomike

Teoria ekonomike na tregon se funksionimi efikas i tregut varet nga një nivel adekuat i konkurrencës në mes prodhuesëve. Kur eksporti mer formën e një investimi greenfield, rezultati është themelimi i një ndërmarje të re, duke e rritur numrin e lojtarëve në treg e me këtë edhe zgjedhjen e konsumatorit. Si pasojë, kjo çon në rritje nivelin e konkurrencës në një treg kombëtar; duke ulur çmimet dhe duke rritur mirëqenien ekonomike të konsumatorëve. Rritja e konkurrencës tenton të stimulojë investimet kapitale nga firmat në fabrikë, pajisje dhe hulumtim dhe zhvillim përderisa ato luftojnë për të fituar një avantazh mbi rivalët e tyre. Rezultatet afatgjata mund të përfshijnë rritjen e produktivitetit, inovacionet e produkteve dhe proceseve dhe rritjen më të madhe ekonomike. Efekte të tilla të dobishme duket se kanë ndodhur në sektorin e shitjes me pakicë në Korenë e Jugut si rezultat i Liberalizimit të rregulloreve të eksportit në vitin 1996. eksportet nga shitore të mëdha lindore, duke përfshirë këtu Wal- Mart, Costco, Carrefour, dhe Tesco, duket se i kane inkurajuar shitësin vendas sic është E-Mart, për ta përmirësuar efikasitetin e veprimtarisë së tyre. Rezultatet e tyre kanë përfshirë konkurrencë në çmime më të ulta, nga e cila përfitojnë konsumatorët e Koresë së Jugut.

Efektii eksportit në konkurrencën e tregut vendas është vecanërisht i rëndësishëm në rastin e shërbimeve, sic janë telekomunikimet, shitja me pakicë, si dhe shumë shërbime të tjera kur eksporti nuk është një opcion. E gjitha kjo sepse shërbimi duhet të prodhohet aty ku dërgohet. Për shembull, sipas njëmarëveshje në vitin 1997, i sponzouruar nga Organizata Botërore e Tregut, 68 shtete duke konsideruar më shumë se 90 përqind e të ardhurave botërore të telekomunikacionit, u zotuan të fillojnë të hapin tregjet e tyre ndaj investimeve të huaja dhe konkurrencës dhe të respektojnë rregullat e përbashkëta për konkurrencën e ndershme në telekomunikacion.

Pas kësaj marëveshje, shumica e tregjeve të telekomunikimeve ishin të mbyllur për konkurentët e huaj, dhe në shumicën e shteteve tregu ishte i monopolizuar nga një karrierë e vetme, e cila shpesh ishte ndërmarje shtetërore. Marrëveshja ka rritur në mënyrë dramatike

nivelin e konkurrencës në shumë tregje të telekomunikimit kombëtar. Duke prodhuar kështu 2 përfitime të mëdha. Së pari, investimii brendshëm ka rritur konkurrencën dhe ka stimuluar investimet në modernizimin e rrjeteve telefonike anembanë botës, duke cuar në shërbim më të mirë. Së dyti, konkurrenca në rritje ka rezultuar me çmime më të ulëta

➤ Efektet negative (anësore) mbi Konkurrencën

Qeveritë nikoqire ndonjëherë shqetësohen se filialet e korporatave multinacionale mund të kenë fuqi më të madhe ekonomike se sa konkurentët vendas. Nëse është pjesë e një organizate më të madhe ndërkombëtare, korporata e huaj multinacionale mund të jetë në gjendje të tërheqë fonde të krijuara diku tjetër, për t'i subvencionuar kostot e saj në tregun nikoqir. Sipas kësaj, i lënë firmat vendase jashtë biznesit dhe i lejojnë firmës ta monopolizojnë marketin. Sapo të jetë monopolizuar marketi, korporata e huaj multinacionale mund t'i rrit cmimet mbi ato që do të mbizotërojnë në tregjet konkuruese, me efekte të dëmshme për mirëqënien ekonomike të kombit nikoqir. Ky shqetësim është më i madh tek shtetet që kanë më pak firma të mëdha të veta (zakonisht shtetet më pak të zhvilluara). Ndërsa ky shqetësim është relativisht i vogël tek shtetet e industrializuara.

Në përgjithësi, përderisa eksporti në formë të investimeve greenfield duhet t'a rrisin konkurrencën, nuk është shumë e qartë se a është ky rasti kur eksportet marrin formën e blerjes së një ndërmarrjeje të themeluar në vendin nikoqir sic ishte rasti kur Volvo e bleu sektorin e gërmimeve të Samsung-ut. Pasi që një blerje nuk rezulton në rritje neto të numrit të lojtarëve në një treg, efektii konkurrencës mund të jetë neutral.

Kur një investitor i huaj blen 2 ose më shumë firma në shtetin nikoqir e më pas i bashkon ato, pasoja mund të jetë zvogëlimii nivelit të konkurrencës në atë treg, të krijojë fuqi monopole në firmën e huaj, ta zvogëlojë zgjedhjen e konsumatorit si dhe të rrit cmimet. Për shembull, në Indi, një firmë private e limituar (Hindustan lever), filialii Unilever-it Indian, e bleu rivalin e saj kryesor vendas, Tata Oil Mills, për të marrë një pozitë dominuese në tregun e sapunëve (75%) dhe detergjenteve (30 përqind). Ato gjithashtu blejtën edhe disa kompani lokale në tregje të tjera, sic ishin krijesit e akulloreve Dollop, Kwaliti dhe Milkfood. Duke i kombinuar këto kompani, aksione e Leverit Hindustan të tregut të akullores nga 0 në vitin 1992, u rritën në 74% në vitin 1997. Megjithatë, edhe pse këto raste janë shqetësime të dukshme, ekziston pak evidencë se zhvillime të tilla janë të përhapura.

Në shumë vende, autoritetet vendase të konkurrencës kanë të drejtën të rishikojnë dhe bllokojnë çdo bashkim apo blerje që ata e shohin ndikojnë negativisht në konkurrencë. Nëse institucione të këtilla operojnë në mënyrë efikase, kjo do të ishte e mjaftueshme për të siguruar se entitetet e huaja nuk i monopolizojnë tregjet e një vendi.

➤ Efektet anësore në bilancin e pagesave

Efektet e mundshme të pafavorshme të eksportit në pozicionin e bilancit të pagesave të vendit nikoqir janë të dyfishta. Së pari, hyrja fillestare e kapitalit që vjen me eksportin duhet të vendoset kundrejt daljes së fitimeve nga filiali i huaj tek kompania vendase. Të dalurat e tilla shfaqen si të dalura të kapitalit në llogaritë e bilancit të pagesave. Disa qeveri janë përgjigjur rrjedhave të tilla duke kufizuar shumën e të ardhurave që mund të riatdhesohen në vendin e origjinës së një filiali të huaj. Një shqetësim i dytë lind kur një degë e huaj importon një numër të konsiderueshëm inputesh nga jashtë gjë që rezulton në një debitim në llogarinë rrjedhëse të bilancit të pagesave të vendit nikoqir. Njëherë, kritikati u drejtuan kah kompanitë automobilistike Japoneze të cilat operonin në SHBA. Konkretisht, ata tentojnë të importojnë pjesë përbërëse nga Japonia. Për këtë arsye, ndikimi i favorshëm i këtyre eksporteve në llogarinë aktuale të pozicionit të bilancit të pagesave të SHBA-ve mund të mos jetë aq i madh sa supozohej fillimisht. Kompanitë japoneze të makinave u janë përgjigjur këtyre kritikave duke u zotuar të blejnë 75 % të pjesëve të tyre përbërëse nga prodhuesit me bazë në SHBA (por jo domosdoshmërisht prodhues vendas Amerikan). Kur kompania automobilistike Japoneze Nissan investoi në Britani, Nissan-i u përgjigj shqetësimeve (kritikave) duke u zotuar për të rritur përqindjen e përmbajtjes lokale në 60 për qind dhe më pas duke e rritur atë edhe më shumë se 80 për qind.

➤ Autonomia dhe sovraniteti kombëtar

Disa qeveri të vendeve nikoqire (pritëse) shqetësohen se eksportet janë të përcjellura me humbje të pavarësisë ekonomike. Problemi qëndron në atë se vendimet kryesore që mund të ndikojnë në ekonominë e vendit nikoqir, do të ndërmerren nga një kompani e huaj që nuk ka detyrim financiar ndaj shtetit nikoqir, dhetë cilën qeveria e shtetit nikoqir nuk e ka nën kontroll. Disa ekonomistë e anashkalojnë këtë çështje duke e konsideruar atë të paarsyeshme. Shkencëtari politik Robert Reich ka vënë në dukje se shqetësimet e tilla janë si rezultat i të menduarit tradicional (vjetëruar) sepse ata dështojnë të japin llogari për ndërvlerësinë e rritjes ekonomike botërore. Në një botë ku kompanitë e vendeve të zhvilluara (të avancuara) investojnë

në tregjet e njëra tjetrës, është e pamundur që një shtet të mbajë një tjetër "shpërblese ekonomike" pa dëmtuar vetveten.

1.7 Prodhimii Brendshëm Bruto (Rritja ekonomike) dhe eksportii mallrave

Prodhimii Brendshëm Bruto (PBB) (en - *Gross domestic product* , GDP) është një tregues ekonomik që paraqet vlerën me çmimet e tregut të të gjitha të mirave materiale dhe shërbimeve të prodhuara brenda një shteti në një periudhë të caktuar (zakonisht një vit).

Prodhimii Brendshëm Bruto nuk duhet ngatërruar me Prodhimin Kombëtar Bruto (PKB) i cili paraqet vlerën me çmimet e tregut të të gjitha të mirave materiale dhe shërbimeve të prodhuara nga burimet e punës dhe pronës së banorëve të një shteti brenda apo jashtë atij shteti në një periudhë të caktuar. GDP-ja është një ndër treguesit kryesorë makroekonomikë për të matur rritjen ekonomike. GDP-ja është dy llojesh reale dhe nominale. GDP-ja reale përfshin mallrat dhe shërbimet përfundimtare të matura me çmime konstante. GDP-ja nominale përfshin mallrat dhe shërbimet përfundimtare të matura me çmime korrente.

➤ Llogaritja sipas prodhimit

"Vlera e tregut e të gjitha mallrave dhe shërbimeve përfundimtare të llogaritura gjatë 1 viti."

Më e drejtpërdrejtë nga tre mënyrat e llogaritjes është ajo sipas prodhimit, e cila mbledh rezultatet e çdo klase të sipërmarrjes për të nxjerrë rezultatin e përgjithshëm.

Kjo metodë përbëhet nga tri faza:

- Llogaritja e Vlerës së Prodhimit (VP) të brendshëm nga aktivitete të ndryshme ekonomike;
- Përcaktimii Konsumit të Ndërmjetëm (KN), pra, kostoja e materialeve, furnizimeve dhe shërbimeve të përdorura për të prodhuar mallrat ose shërbimet përfundimtare
- Zbritja e Konsumit të Ndërmjetëm nga Vlera Bruto për të marrë Vlerën e Shtuar Bruto të prodhimit të brendshëm.

Simbolikisht,

Vlera e Shtuar Bruto = Vlera e Prodhimit - Vlera e Konsumit të Ndërmjetëm.

Vlera e Prodhimit = Vlera e shitjeve totale të mallrave dhe shërbimeve + Vlera e ndryshimeve në inventar.

Shuma e Vlerës së Shtuar Bruto të aktiviteteve të ndryshme ekonomike duke shtuar taksat indirekte dhe duke zbritur subvencionet mbi produktet jep PBB-në sipas metodës së prodhimit.

➤ Llogaritja sipas të ardhurave

"Shuma totale e të ardhurave të individëve që jetojnë në një vend gjatë 1 viti."

Një tjetër mënyrë për të matur PBB-në është duke llogaritur të ardhurat totale. PBB e llogaritur në këtë mënyrë quhet ndryshe të Ardhurat e Brendshme Bruto (ABB). Kjo metodë mat PBB duke mbledhur të ardhurat e kompanive dhe punonjësve siç janë pagat e punës, interesii kapitaleve, qiratë për tokën dhe pronën dhe fitimet e sipërmarrjeve.

Dy rregullime duhet të bëhen për të marrë PBB:

Taksat indirekte minus subvencionet janë shtuar për të marrë nga kostos faktor në çmimet e tregut. Amortizimi është shtuar për të marrë nga produkti neto të brendshëm të prodhimit të brendshëm bruto. Totalii të ardhurave mund të ndahen sipas skemave të ndryshme, duke çuar në formula të ndryshme për PBB-në matur me metodën e të ardhurave. Një formulë e zakonshëm është:

$$PBB = \text{Pagat e Punonjësve} + \text{Teprica Bruto Operative} + \text{të Ardhurat Bruto të Përziera} + \text{Taksat} - \text{Subvencionet për prodhimin dhe importet}$$

$$PBB = PP + TBO + ABP + T - S$$

Pagat e punonjësve (PP) mat pagesën totale të punonjësve për punën e bërë. Ato përfshijnë pagat dhe rrogat, si dhe kontributet e punëdhënësve për sigurimet shoqërore dhe programet e tjera.

Teprica Bruto Operative (TBO) është tepricë për shkak të pronarëve të bizneseve të inkuorporuara. Shpesh quhet fitim, edhe pse vetëm një mesatare e kostos totale zbritet nga prodhimi bruto i llogaritur.

Të ardhurat bruto të përziera (ABP) është masë e njëjtë si TBO, por për bizneset painkuorporuara. Kjo shpesh përfshin biznese më të vogla. Shuma e PP, TBO dhe ABP quhet faktorii përgjithshëm i të ardhurave, por është të ardhurat e të gjithë faktorëve të prodhimit në shoqëri. Ai mat vlerën e PBB-së në faktor (bazë) e çmimeve. Dallimi në mes çmimet bazë dhe çmimet përfundimtare (ato që përdoren në llogaritjen e shpenzimeve) është taksat totale dhe

subvencionet që qeveria ka vëna ose paguar në atë të prodhimit. Pra, duke shtuar taksat më pak subvencionet për prodhimin dhe importet konverton PBB në kosto faktor me ABB. Totalii të ardhurave faktor është gjithashtu shprehur nganjëherë si:

Totalii të ardhurave faktor = Paga e Punonjësve + fitimet e korporatave + të ardhurat pronarit + të ardhurat nga qiraja + interes Net.

Megjithatë, një tjetër formulë për PBB sipas metodës të ardhurave është:

$$PBB = Q + I + F + RS + P$$

ku Q: Qiratë I: Interesat e F: fitimi RS: rregullime statistikore (taksat e korporatave të ardhurat, dividendët, fitimet e pashpërndara të korporatave) P: pagat

➤ Llogaritja sipas shpenzimeve

"Të gjitha shpenzimet e bëra nga individë gjatë 1 viti."

Në ekonomi, gjërat më të prodhuara janë prodhuar për shitje, dhe shiten. Prandaj, matjen e shpenzimeve totale të parave të përdorura për të blerë gjëra është një mënyrë e matjes së prodhimit. Kjo është e njohur si metoda e shpenzimeve të llogaritjes së PBB-së. Vini re se në qoftë se ju i bëni vetes një triko, është prodhim, por nuk merret parasysh si PBB-së, sepse ajo kurrë nuk është shitur. Prodhimii trikove është një pjesë e vogël e ekonomisë, por në qoftë se dikush i llogarit disa aktivitete të mëdha të tilla si rritja e fëmijëve (përgjithësisht të papaguara) si prodhim, PBB nuk do të ishte një tregues i saktë i prodhimit.

Rritja ekonomike është përcaktuar si një ndryshim pozitiv në të ardhurat kombëtare ose ndryshimii nivelit të prodhimit të mallrave dhe shërbimeve nga një vend në tjetrin përgjatë një periudhe të caktuar. Agregatii kërkesës për mallra të fundme mishërohet në dy tregues të rëndësishëm makro, respektivisht tek prodhimii brendshëm bruto dhe te prodhimi kombëtar bruto . Gjithashtu një tjetër koncept i rëndësishëm në makro është edhe agregatii të ardhurave i cili përfaqëson totalin e të ardhurave që ofrohen nga përpunimii futjeve ose i faktorëve të prodhimit (toka, puna, kapitali) me të cilët realizohen mallrat dhe shërbimet në një ekonomi përgjatë një viti. PBB llogaritet në tre alternativa bazë :

- a) Si shumë mallrash dhe shërbimesh të fundme-si shumë e kërkesës së fundme
- b) Si shumë e pagesave të faktorëve të prodhimit.

c) Si shumë e vlerave të shtuara.

PBB si shumë mallrash dhe shërbimesh të fundme (si shumë e kërkesës së fundme) Funksioni bazë i PBB është shuma e blerjeve të mallrave të fundme nga konsumatorët, blerjet e mallrave të fundme nga firmat, blerjet e mallrave të fundme nga qeveria qendrore apo lokale dhe diferenca e eksporteve dhe importeve . Në llogaritjen e PBB dhe PBK duhen mbajtur parasysh këto çështje kryesore:

- Mallra dhe shërbime të fundme që blihen dhe shiten përfundimisht dhe jo për rishitje.
- Mallra dhe shërbime të fundme të Qeverisë të cilat realisht nuk kanë çmim, por vlerësohen me koston e futjeve për prodhimin e tyre – p. sh me shpenzimet e arsimit, rendit, pagat punonjësve etj., sepse këto i shtohen po kaq PBB dhe PBK.
- Mallrat e prodhuara gjatë vitit por që në fund të vitit janë gjendje të pashitura në pikat e shitjes, por konsiderohen të shitura me çmimin e blerjes dhe si blerës të fundmë konsiderohen vetë tregtarët që i kanë në këto pika shitjeje.
- Mallrat që karakterizohen si investime – p.sh. makineritë, fabrikat, të cilat konsiderohen si mallra të fundme vetëm për ato që prodhohen e blihen në vitin ushtrimor.

Mallrat gjendje në pikat e shitjes apo në fabrikë quhen të blera nga vetë pronarët e fabrikës, punishtes, makinerisë etj., dhe nuk përfshihen fabrikat dhe makineritë e viteve të kaluara. PBB si shumë e pagesave të faktorëve të prodhimit. Faktorët e prodhimit në formën e shumës së pagesave për këto faktorë shërbejnë për llogaritjen PBB në një formë të saj. Kjo llogaritje i referohet pagesave në të holla që bëjnë palët blerëse të faktorëve të prodhimit , por nga ana tjetër faktorët që blihen janë kosto blerjeje për prodhuesit/ përpunuesit e tyre, por nga ana tjetër janë të ardhura nga shitja për shitësit e faktorëve të prodhimit si pagesa për punën, qiraja për tokën, interesi për kapitalin, fitimi për ndërmarrësinë. PBB si shumë e vlerave të shtuara si shumë e të ardhurave të kontribuuesve në PBB Llogaritja e PBB si shumë e vlerave të shtuara i referohet diferencës ndërmjet vlerës së blerjes së faktorëve të prodhimit të një produkti me vlerën e arkëtuar nga shitja e produktit në fjalë duke e parë si proces zinxhir nga prodhuesit tek tregtari e deri në fund tek konsumatori. Të gjitha palët kontribuojnë në PBB, prandaj njihet si shumë të ardhurash të kontribuuesve në PBB. Raportii PBB nominal i një viti ushtrimor me PBB

reale të të njëjtit vit njihet si deflatorii PBB, i cili mat dhe informon se sa është inflacioni. Llojet e produktit të brendshëm bruto

Një lloj PBB që përdoret më shumë është PBB nominale që rezulton nga vlerësimi mallrave dhe shërbimeve të fundme me çmimet e ushtrimeve të vitit që merret në konsideratë. Por nga ana tjetër kemi edhe PBB reale që rezulton nga vlerësimi mallrave dhe shërbimeve të fundme me çmimet e një periudhe bazë duke shmangur ndikimin e inflacionit. PBB real është dhe vlerësimi më i saktë i PBB sepse shmang ndikimin në rritjen e vlerës së PBB nga ndikimi rritjes së çmimeve (inflacionit). Ekonomi të ndryshme pavarësisht sa PBB ofrojnë në një vit të caktuar, ata kanë një PBB të ndryshëm nga ajo që kanë ofruar. Kjo njihet ndryshe me PBB potenciale që rezulton nga vlerësimi mallrave dhe shërbimeve të fundme të realizuara kundrejt punësimit të plotë të inputeve dhe faktorëve të prodhimit në procesin e prodhimit. Produkti tërësor potencial i vendit është koncept bazë në përcaktimin e kostos ekonomike të papunësisë së faktorëve të prodhimit. Diferenca e PBB potencial me PBB real njihet si hendeku (honi) i prodhimit ose honii PBB. Honi është më i madh sa më i ulët që të jetë niveli i PBB real dhe aq më i vogël sa më i lartë që të jetë niveli i PBB reale. Niveli i honit ndryshon sipas ciklikës së biznesit, ku ky hon është më i lartë në ciklin rënës dhe më i ulët kur ekonomia është në rritje. Nqs ekonomia nuk do operonte në kushtet e saj optimale do nënkuptohej që bizneset nuk po operonin në maksimumin e tyre dhe anasjelltas.

II. KAPITULLI DYTË

Ekonomia e Republikës së Maqedonisë dhe gjendja aktuale

2.1 Dy dekadat tranzitive e ekonomisë së Republikës së Maqedonisë

Maqedonia u shpall si Republikë në 8 shtator të vitit 1991, pas ndarjes nga ish Federata Jugosllave. Ajo trashëgoi një prapambetje të madhe thuajse në të gjithë sektorët e ekonomisë. Njëkohësisht edhe sektori financiar i cili dominohej më së shumti nga sektori bankar me kapital tërësisht shtetëror, nuk mund të ishte ndryshe. Pas vitit 1991 dhe në vijim u bë një punë emadhe për krijimin dhe konsolidimin e sistemit bankar me dy nivele. Në Maqedoni u çelën dhe filluan aktivitetin e tyre një numër i madh bankash të huaja me kapital tërësisht privat. Në këtë mënyrë privatizimii bankave shtetërore dhe futja e kapitalit të huaj ndikuan në zgjerimin vertical dhe horizontal të këtij sistemi. U rrit numri i produkteve apo shërbimeve bankare si dhe sisteminëpërmjet degëve dhe filialeve u shtri në gjithë teritorin e Maqedonisë. Me aktivitetin e tyre bankat tregtare kanë dhënë dhe po japin ndikimin e tyre në rritjen, zhvillimin dhe konsolidimin e ekonomisë maqedone.

Më 26.04.1992, me miratimin e disa akteve ligjore në fushën e politikave monetare dhe të këmbimit valutor, u shpall akti i pavarësisë monetare të Republikës së Maqedonisë. Akti i pavarësisë monetare u shoqërua me krijimin e Bankës Kombëtare të Republikës së Maqedonisë, si bankë e pavarur përgjegjëse për stabilitetin e monedhës, politikës monetare dhe likuiditetit të përgjithshëm të pagesave të vendit ndaj botës së jashtme, më pas me lëshimin në qarkullim parave të veta, denarit si valutë ligjore në vitin 1992, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë për herë të parë përcaktoi politikën e vet monetare. Në periudhën pas pavarësisë monetare, sistemi bankar i nënshtrohet reformës dhe rindërtimit të llojit të vet. Këto procese në thelb nënkuptojnë rehabilitimin, riorganizimin dhe privatizimin e bankave në vend. Këto ndryshime u pasuan me rritje të detyrueshme ligjore të kapitalit themelues të bankave që kanë kontribuar në rritjen e caktuar (edhe pse larg nga e nevojshmja) të forcës kapitale dhe konkurrencës së bankave.

Paralelisht me të gjitha këto ndryshime, në sistemin bankar është zhvilluar kontrolli mbikëqyrës i bankave, së pari nëpërmjet formësimit të legjislacionit dhe pastaj përforcohet përmes kontrollit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të bankave të nivelit të dytë. Bankat që janë

krijuar pas pavarësisë monetare pothuajse krejtësisht janë private, duke pasur parasysh atë që themeluesit e tyre, kryesisht, janë kompani private. Shkalla e privatizimit për bankat që u krijuan në periudhën kur Maqedonia ishte pjesë e Jugosllavisë së mëparshme, lëvizi midis 60-80%.

Rindërtimin dhe rehabilitimin e sistemit bankar në vend lejoi ndërmarrjen e masave të nevojshme për zbatimin marrëveshjeve me Bankën Botërore dhe Fondin Monetar Ndërkombëtar. Pjesë e reformave në sektorin financiar dhe ekonomik ishte edhe reforma në sistemin e brendshëm të pagesave. Qëllimi kryesor është futja e sistemit të pagesave moderne që do të përmbushë kërkesat e të gjitha palëve të përfshira në sistemin e pagesave të brendshëm (komitentët, bankat, Bankën Qendrore). Banka Qendrore mbikëqyr veprimtarinë e bankave dhe institucioneve të tjera që ofrojnë shërbime të pagesave.

Pas vitit 2001, konsolidimi buxhetor u shoqërua gjithashtu, nga ndjekja e suksesshme e një pozicioni të shtrënguar monetar. Banka Kombëtare e Republikës së Maqedonisë ka fiksuar de facto denarin maqedonas ndaj euros, duke e mbajtur inflacionin në kontroll (Krstevska, 2009).

Gjatë dhe pas vitit 2008 edhe Maqedonia, ashtu si gjithë vendet e tjera të Europës, u përball me krizën e përgjithëshme financiare. Banka Qendrore e Maqedonisë reagoi duke zbatuar politika ekspansioniste monetare. Ajo uli disa herë normën bazë të interesit në mënyrë që tëndikonte pozitivisht në politikat e bankave tregtare për uljen e normave të interesit të kredive duke i bërë kreditë më atraktive për bizneset dhe në këtë mënyrë, nëpërmjet rritjes së tyre për tëndikuar në rritjen e ekonomisë dhe në konsolidimin e sistemit bankar. Por gjithsesi kriza financiare pati pasojat e saj negative edhe në sistemin bankar maqedon.

Nga ana tjetër, rritja e ekonomisë së Republikës së Maqedonisë u zgjerua me 3.7 për qind në vitin 2015 (tabela më poshtë).

2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
-4.5	.9	2.8	4.7	4.7	5.1	6.5	5.5	-.4	3.4	2.3	-.5	2.9	3.6	3.8	2.9

Burimi: Enti Statistikor i Maqedonisë
(http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat__BDP)

Rritja është nxitur kryesisht nga ndërtimet (16.8 përqind), tregtia me shumicë dhe pakicë (7.3 për qind) dhe shërbimet (3.4 për qind), sidomos pasuritë e paluajtshme, të nxitur nga rritja e suksesshme e kreditimit. Prodhimi industrial u tkurr me 2 për qind ndërsa rimëkëmbja në

gjysmën e dytë të vitit 2015, kompensoi pjesërisht ngadalësimin në gjysmën e parë të vitit. Së fundi, prodhimi bujqësor është ngadalësuar, pavarësisht përfitimit të më shumë subvencioneve (tabela më poshtë).

Komponentat e PBB nëpër sektorë

	Vlerat (denarë million)						
	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
	Vlera bruto	Vlera bruto	Vlera bruto	Vlera bruto	Vlera bruto	Vlera bruto	Vlera bruto
A –Bujqësia, pyllëtaria dhe peshkataria	83 426	85 527	81 230	91 764	96 388	97 405	98 860
02. Pyllëtaria dhe pyjet	3 122	2 924	3 087	3 603	5 228	4 212	4 078
B - Xehetaria	11 288	11 976	12 116	12 672	12 788	13 336	11 743
07. Nxjerja e mineraleve	7 538	8 147	8 606	8 892	8 761	8 854	7 424
B –Industria prodhuese	222 755	253 299	234 315	217 910	246 860	274 217	297 456
13. Tekstili	3 170	2 672	3 204	3 858	4 456	5 643	6 742
32. Industria tjetër	955	720	904	1 440	1 402	1 022	1 120
G - Ndërtimtaria	71 050	77 740	79 941	95 763	95 946	104 422	111 082
79. Turizmi	3 327	3 744	2 944	3 207	3 677	4 044	3 834

Burimi: Enti Statistikor i Maqedonisë

(http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat__BDP)

Në aspektin e kërkesës, rritja u nxit kryesisht nga konsumi, si privat dhe publik. Rritja e punësimit e kombinuar me nivele më të larta në terma realë të pagave, pensione dhe transfertave sociale, çoi në një rritje me 3.2 për qind të konsumit privat në 2015. Shpenzimet qeveritare të konsumit gjithashtu u rritën ndjeshëm në 2015 (4.6 përqind), sidomos në gjysmën e dytë të vitit. Investimet bruto u rritën në tremujorin e tretë, të stimuluar nga rritja e shpenzimeve publike për ndërtimin e autostradës. Rritja në kreditë afatgjata për shoqëritë e biznesit sugjeron se investimet private gjithashtu u përmirësuan nga fundi i vitit 2015. Eksportet (kryesisht të lidhura me IHD-të) vazhduan të kenë performancë të mirë duke u rritur me 4.6 për qind v-m-v. Rritja e importeve ishte pothuajse e papërfillshme në tre tremujorët e parë, por një rritje e konsiderueshme e importeve të lidhura me IHD-të në tremujorin e fundit çoi në rritjen e importeve në 2.4 për qind për të gjithë vitin. Kërkesa e jashtme neto pati kontribut pozitiv (edhe pse modest) në rritjen e PBB-së (0.7 për qind vm-v) (World Bank Group, 2016).

Sa i përket strukturës së populates në aspektin e aktivitetit të tyre në punë dhe të papunët, sipas statistikave (tabela më poshtë) mund të themi se punësimi u rrit me gati 1 për qind në vitin

2015, për shkak të punësimeve të reja në sektorin e industrisë, në administratën publike dhe shërbime (sidomos strehim, shërbime financiare dhe pasuri të paluajtshme).

Popullata aktive punëtore

			2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
	Punësuar	Gjithësejt	637 855	645 085	650 554	678 838	690 188	705 991	723 550	740 648
Total	Papunë	Gjithësejt	300 439	294 963	292 502	277 219	268 809	248 933	225 049	213 564

Burimi: Enti Statistikor i Maqedonisë
(http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat__PazarNaTrud)

Pjesëmarrja në forcën e punës vazhdoi të jetë e qëndrueshme në nivelin 57.2 përqind. Nivelii papunësisë ra në një mesatare prej 26.1 për qind në vitin 2015, krahasuar me 28.1 për qind në vitin 2014. Norma e papunësisë tek të rinjtë u zvogëua ndjeshëm, nga 53.1 për qind në vitin 2014 në 47.3 përqind në vitin 2015, kurse 2017 papunësia rra në 22 përqind si pasojë të ndihmesësë programevetë kushtueshme të punësimit të të rinjve. Megjithatë, papunësia afatgjatë mbetet problem: 61 për qind e të papunëve të regjistruar raportojnë se kane qenë pa punë për më shumë se një vitë.

Pasiguria politike dhe kriza e refugjatëve janë rreziqet kryesore për ekonominë. Zgjedhjet e përgjithshme në 2016, nëvarësi të zgjidhjes së kënaqshme të çështjeve që lidhen me regjistrin e votuesve, si dhe ligjin për mediat dhanë tronditje në ekonominë e vendit. Pasiguritë e zgjatura politike mund të ndikojnë vendimet për investime dhe ngadalsojnë aktivitetin ekonomik. Përshkallëzimi i krizës aktuale të refugjatëve mund të jetë gjithashtu një rrezik, veçanërisht në qoftë se BE-ja vendos të mbyllë kufijtë e saj, ose të kufizojë hyrjen në masë të konsiderueshme (World Bank Group, 2016¹⁰).

Qytetarët kanë 3,8 miliardë euro në banka, depozitat të sigurta. Depozitat e qytetarëve në bankat dhe kursimoret në vend janë të sigurta, sipas Fondit për Sigurim të Depozitave në Republikën e Maqedonisë, në raportin vjetor dhe publikimet të Ditës Botërore të Kursimeve - 31 tetori. Sipas drejtorit të Fondit për Sigurim të Depozitave në Republikën e Maqedonisë "Depozitat e kursimeve për secilin depozitues në shumë deri në 30 mijë euro në kundërvlerë të denarit janë të siguruar në Fond dhe janë të sigurta. Dhe nëse ndonjë bankë ose kursimore ka ndonjë ngjarje të rrezikshme, ata depozitues kompensohen". Të dhënat nga Fondi tregojnë se për

¹⁰World Bank Group, (2016) Europa Juglindore, Raporti i rregulltë ekonomik Nr.9 – Ribalancim për një rritje më të forte, fq. 70-71

momentin shtetasit e Maqedonisë kanë 3,8 miliardë euro kursime në banka dhe kursimoret në vend. Më shumë se gjysma apo 50,5 për qind", pra, sipas tyre, janë në denarë, ndërsa 49,5 për qind në euro. Sipas tij, shumica e kursimeve në denarë me siguri ka të bëjë në normat më të larta të interesit të këtyre depozitave kursyese por edhe të kursit të qëndrueshëm të denarit. Fondit për Sigurim të Depozitave në Republikën e Maqedonisë porosit qytetarët vetëm të kursejnë dhe se nuk ka rëndësi në cilën monedhë.

2.2 Gjendja aktuale e ekonomisë së Republikës së Maqedonisë

Maqedonia është një vend i vogël me një PBB rreth 11,3 miliardë dollarë në vitin 2014 (Word bank 2015), që në vitin 2010 me PBB 9,17 miliardë dollarë, u vlerësua me 0,01% të outputit totalbotëror. Ajo gjithashtu është një ekonomi e hapur, e integruar në tregtinë ndërkombëtare menormë tregtare të PBB-së prej 81,6% në vitin 2009 (U.S Department of State-Bureau of European Affairs, Mars 2011).

Që nga viti 1996, Maqedonia ka ruajtur stabilitetin makroekonomik me inflacion të ulët, por deri tani ajo ka ngecur në tërheqjen e investimeve të huaja dhe në krijimin e vendeve të punës, pavarësisht bërjes së reformave të gjera në sektorin fiskal dhe të biznesit. Remitancat e punëtorëve dhe ndihma e huaj e kanë zbutur periudhën e mëvonshmetë paqëndrueshme. PBB-ja është rritur çdo vit, përveçse në vitin 2001 për shkak të luftësndëretnike, në vitin 2009 si pasojë e krizës ekonomike globale dhe në vitin 2012 si pasojë e një recesioni ekonomik. Më tej pati rimëkëmbje në vitin 2013 me rritjen ekonomike tëmbështetur nga rimëkëmbja në shtetet me të ardhura të larta, veçanërisht në shtetet e Bashkimit Evropian (BE).

Ekonomia është rimëkëmbur gradualisht që nga viti 2012 dhe në tremujorin e dytë në vitin 2013, kështu që rritja e PBB-së arriti në 3.9% në krahasim me një vit më parë. Kjo erdhisi pasojë e rritjes së investimeve, edhe pse rritja ishte më e ngadaltë, nga një mesatare prej 16% në vitin 2012, në një mesatare prej 8.2% në gjysmën e parë të vitit 2013 (European Commission, Former Yugoslav Republic of Macedonia, 2013, Progress Report).

Tek tabela më poshtë vijojnë të dhënat dhe parametrat statistikore për ekonominë e Republikës së Maqedonisë si dhe parashikimet makroekonomike prej 2013 deri 2019, më pas vijojnë edhe analizat konçize ekonomike.

MAQEDONISË	2013	2014	2015	2016^f	2017^f	2018^f	2019^f
Rritja e PBB-së Reale (ndryshimi në % ,v-m-v)	2.9	3.6	3.8	2.4	2.8	3.3	3.8
<i>Përbërja (pikë përqindje):</i>							
Konsumi	1.4	1.6	3	3.1	2.9	2.1	2
Investimet	0.1	3.8	0	-1.4	0	0.7	1.1
Eksportet neto	1.3	-1.7	0.7	0.7	0.3	0.4	0.7
Eksportet	2.6	8.2	2.4	5.9	4.3	4	3.9
Importet (-)	1.3	9.9	1.7	5.2	4	3.6	3.2
Inflacioni i çmimeve të konsumit (ndryshimi në përqindje, v-m-v, mesatare e periudhës)	2.8	-0.3	-0.3	-0.2	0.6	1.4	1.8
Të ardhura publike (përqind e PBB-së)	30.2	29.8	30.9	30	30.3	30.3	30.3
Shpenzimet publike (përqind e PBB-së)	34.2	34	34.5	32.6	33.5	33	32.6
<i>Prej të cilave:</i>							
Shpenzime për paga (përqind e PBB-së)	7.2	7	6.9	6.9	6.9	6.8	6.8
Asistence sociale (përqind e PBB-së)	14.8	14.9	14.8	14.8	14.8	14.8	14.8
Shpenzime kapitale (përqind e PBB-së)	4.4	4.3	4.4	3	4.1	4.2	4.3
Bilanci fiskal (përqind e PBB-së)	-3.9	-4.2	-3.6	-2.6	-3.2	-2.7	-2.3
Bilanci primar fiskal (përqind e PBB-së)	-2.9	-3.2	-2.3	-1.5	-1.9	-1.4	-0.8
Borxhi publik (përqind e PBB-së)	34.2	38.2	37.9	390.0	41.0	42.1	44.0
Borxhi publik dhe borxhi i garantuar (përqind e PBB-së)	40.5	45.9	46.4	47.7	50.6	52.3	55.8
Prej të cilit: I Jashtëm (përqind e PBB-së)	28.5	31.9	31.3	3383	34.7	35.9	37.2
Eksportet e mallrave (përqind e PBB-së)	29.2	32.4	33.5	34.3	34.2	34.3	34.5
Importi i mallrave (përqind e PBB-së)	32	34.1	33.6	33.1	34.5	34.6	34.5
Eksportet neto të shërbimeve (përqind e PBB-së)	4.6	4.2	3.8	4	4.2	4.5	4.6
Bilanci tregtar (përqind e PBB-së)	-18.3	-17.6	-16.4	-14.7	-13.6	-12.2	-11.5
Fluksi hyrës i remitancave (përqind e PBB-së)	2.2	2.2	2.1	2.1	2	2	1.9
Bilanci i llogarisë korrente (përqind e PBB-së)	-1.6	-0.6	-2	-3.1	-3	-2.7	-2.1
Flukset hyrëse të Investimeve të huaja direkte (përqind e PBB-së)	2.8	2.3	2.3	3.6	2.5	2.7	2.9
Borxhi i jashtëm (përqind e PBB-së)	64	70	69.4	74.1	74.7	75.1	73.8
Rritja reale e kredimit privat (përqind, mesatare e periudhës)	4.9	10.3	9.9	6.7	6	5.3	5
Kreditë me probleme (përqind e totalit të kredive, fundi i periudhës)	11.3	11.1	10.6	6.5	6	5.7	5.2
Norma e papunësisë (përqind, mesatare e periudhës)	29	28	26.1	23.7	22	20.2	19.4
Norma e papunësisë e të rinjve (përqind, mesatare e periudhës)	51.9	53.1	47.3	48.3	48.5	48	47.6
Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës (përqind, mesatare e periudhës)	57.2	57.3	57	56.8	56.6	56.7	56.9
PBB-ja për frymë, PPP (dollarë aktualë ndërkombëtarë \$)	12,468	12,938	13,330	13,583	13,836	14,355	14,814
Norma e varfërisë në kufirin US\$5/ditë, PPP (përqind e popullsisë)	34.3	33.6	32.3	31.7	30.5	29.3	

Burimi: Autoritetet e vendit, Vlerësime dhe projeksione të Bankës Botërore.

Shënime: Të dhënat për remitancat i referohen vetëm remitancave nga punëtorët dhe jo të gjitha transfertave private të cilat janë shumë më të larta

Të dhënat paraprake nga tabela sipër tregojnë se ekonomia e Republikës së Maqedonisë u zgjerua me 3.7 për qind në vitin 2015. Rritja është nxitur kryesisht nga ndërtimet (16.8 për qind), tregtia meshumicë dhe pakicë (7.3 për qind) dheshërbimet (3.4 për qind), sidomos pasuritë epaluajtshme, të nxitur nga rritja esuksesshme e kreditimit. Prodhimi industrialu tkurr me 2 për qind ndërsa rimëkëmbja nëgjysmën e dytë të vitit 2015, kompensoipjesërisht ngadalësimin në gjysmën e parë tëvitit. Së fundi, prodhimi bujqësor ështëngadalësuar, pavarësisht përfitimit të mëshumë subvencioneve.

Rritja e punësimit e kombinuar menivele më të larta në terma realë të pagave, pensione ve dhe transfertave sociale, çoi nënjë rritje me 3.2 për qind të konsumit privat në 2015. Shpenzimet qeveritare të konsumit gjithashtu u rritën ndjeshëm në 2015 (4.6 për qind), sidomos në gjysmën e dytë të vitit. Investimet bruto u rritën në tremujorin etretë, të stimuluar nga rritja e shpenzimeve publike për ndërtimin e autostradës. Rritja nëkreditë afatgjata për shoqëritë e biznesit sugjeron se investimet private gjithashtu upërmirësuan nga fundi i vitit 2015. Eksportet (kryesisht të lidhura me IHD-të) vazhduan tëkenë performancë të mirë duke u rritur me 4.6 për qind. Rritja e importeve ishtëpothuajse e papërfillshme në tre tremujorë të parë, por një rritje e konsiderueshme e importeve të lidhura me IHD-të në tremujorin e fundit çoi në rritjen e importeve në 2.4 për qind për të gjithë vitin. Kërkesa e jashtme neto pati kontribut pozitiv (edhe pse modest) në rritjen e PBB-së (0.7 për qind).¹¹

Rënia e çmimeve ndërkombëtare të ushqimeve dhe të naftës ndikoi lëvizjet e çmimeve të brendshme dhe çoi në një rënie të përgjithshme të çmimeve prej 0.3 për qind. Ndërkohë, inflacioni bazë u rrit pak, me 0.5 për qind, i ndikuar nga çmimet më të larta për produktet farmaceutike dhe pajisjet e TI-së.

Eksportet të shprehura në Euro u rritën me 9.0 për qind në 2015, ndërsa të shprehura në dollarë amerikanë ato u zgjeruan në të njëjtën masë pasi denari, i cilika kurs këmbimi fiks me Euron, pësoi zhvlerësim kundrejt dollarit. Pjesa më e madhe e rritjes është nxitur nga eksportet e lidhura me IHD-të, të cilat përbëjnë gati 40 për qind të totalit të eksporteve. Eksportet nga segmenti tradicional, të tilla si hekuri dhe çeliku, mineralet dhe skorjet, dhe duhani u zgjeruan. Destinacionet e eksportit u bënë më të përqendruara: 44 për qind e eksporteve (kryesisht pjesë dhe komponentë që kanë të bëjnë me sektorin e automjeteve), shkuan

¹¹ Evropa Juglindore 2016 „, Raporti i rregulltë Ekonomik Nr.9,, Riballancim për një rritje më të fortë – World Bank Group fq.65

në Gjermani, krahasuar me 41 përqind në vitin 2014. Pas rënies në tremujorin e tretë, importet u ngritën përsëri gjatë fundit të vitit, duke e çuar rritjen vjetore të 2015-ës në 5.5 përqind. Sirezultat, deficitin tregtar u ngushtua me 19 përqind, duke arritur në rreth 17 përqind të PBB-së.¹²

Megjithëse transfertat private ishin më të ulëtase sa në vitin 2014, ato ishin ende të mjaftueshme për të mbuluar deficitin tregtar duke ulur presionin e financimit të jashtëm. Deficitin llogarisë korente u zgjerua në nivelin 1.4 përqind të PBB-së, nga 0.8 përqind në vitin 2014. Deficitin financohet kryesisht nga investimet e huaja direkte. IHD-të neto u ulën me 14 përqind (në terma vjetorë) në vitin 2015, duke rënë në 1.9 përqind të PBB-së nga 2.3 përqind në vitin 2014. Kjo ndodh kryesisht për shkak të flukseve dalëse të kapitalit në Maj 2015 (kulmi i pasigurive politike në vend dhe krizës Greke) dhe mëvonë në Shtator dhe Nëntor. Ashtu si në vitin 2014, rezervat mbuluan vlerën e 4.6 muajve importe.

Kreditë me probleme (NPL-të) ranë në 10.6 përqind në Dhjetor, për shkak të rënies së kredive me probleme të korporatave. Sektori bankavazhdon të ketë likuiditet të lartë (mesatarisht 28.5 përqind në periudhën Janar-Shtator 2015). Fitimet u rritën në tre tremujorët e parët të vitit 2015, dhe norma e mjaftueshmërisë së kapitalit ishte 16 përqind, shumë më e lartë se niveli i mandatur prej 8 përqind. Rritja e kreditimit arriti në 9.5 përqind (v-m-v) në vitin 2015, pak më poshtë se rritja prej 9.8 përqind në vitin 2014; kreditë për familjet përbënin 57 përqind të zgjerimit.

Totali i ardhurave arriti në 28.8 përqind të PBB-së në vitin 2015 me rritje nga niveli 27.8 përqind në vitin 2014. Rritja u nxit nga rikthimi i zbatimit të tatimit për pjesën e fitimeve që nuk riinvestohen (e mbledhur që nga viti 2009), dhëna kontributet më të larta sociale të lidhura me tregun e përmirësuar të punës. Të ardhuranga TVSH-ja, që përbëjnë gati një të tretën e ardhurave tatimore, patën performancë të dobët pavarësisht rritjes së lartë ekonomike dhe konsumit. Ky rezultat vlerësohet se ka ardhur për shkak të një kombinimi faktorësh, të tillë si rënia e çmimeve të naftës, problemet e mbledhjes së ardhurave, si dhe prirja në rritje të segmentit të IHD-ve të përjashtuaranga TVSH-ja. Shpenzimet në vitin 2015 u rritën më pak se të ardhurat, por ato janë në nivelin 32.3 përqind të PBB-së dhe u rritën me 32 përqind në krahasim me vitin 2014. Kjo rritje kryesisht reflekton nivelet më të larta të pagave të sektorit publik, pensione, transfertave sociale dhe shpenzimeve për mallra dhe shërbime, veçanërisht në pjesën e vitit 2015. Qeveria qendrore nuk realizoi plotësisht shpenzimet e planifikuara

¹²Njëjtë

kapitale, pavarësisht rritjeve të parashikuara në rishikimin e buxhetit në mes të vitit.

Megjithatë, shpenzimet kapitale nga agjencitë publike joqeveritare kompensuan performancën e dobët të qeverisë. Deficit i qeverisë qendrore në vitin 2015 arriti në 3.5 për qind të PBB-së, që është nivel më i ulët separashikimi në buxhetin e rishikuar (3.7 për qind) dhe se rezultati në vitin 2014 (4.2 për qind). Diferenca midis deficiteve aktuale dhe të projektuara kryesisht reflekton transferimin e kontributeve nga fondet pensioneve me financim shtetëror në fondet private (rreth 0.1 për qind e PBB-së), që ishin të lidhura me vitin 2015, poru shtynë deri në Janar 2016.

Duke analizuar PBB nga ana e shpenzimeve, shkalla e lartë e rritjes së investimeve brutoprej 11.4% (si rezultat, mbi të gjitha, në rritjen e regjistruar në tremujorin e dytë prej 25.8%), kufizoi rënien e PBB-së dhe në të njëjtën kohë krijoi bazat për forcimin e aftësisë konkurruese të ekonomisë në periudhën vijuese. Konsumi final u ul me 0.3% në terma realë në tre tremujorët e parë. Në këtë mënyrë, konsumi personal u ul me 0.5%, ndërsa konsumi publik u rrit me 0.6%. Eksporti i mallrave dhe shërbimeve regjistroi rënie mesatare reale prej 0.8% në tre tremujorët e parë, ndërsa importi i mallrave dhe shërbimeve shënoi rritje mesatare reale prej 3.5%. (Ministria e Financave të Republikës së Maqedonisë, 2013).

Ekonomia vendore vazhdoi të rritet edhe në tremujorin e tretë të vitit 2013, me një normë rritjeje tremujore prej 1,1%. Aktiviteti ekonomik rritet edhe më tej në mënyrë solide në termavjetorë me normë të rritjes prej 3,3%. Sikurse në tremujorin e mëparshëm, rritja rrjedh ngazhivillimet në sektorin e ndërtimit, por edhe nga zhvillimet pozitive në veprimtaritë e tjera, me përjashtim të administrimit publik. Kështu, ndërtimi edhe në tremujorin e tretë ishte faktor i rëndësishëm në rritjen e ekonomisë, pjesërisht i ndihmuar nga impulsi pozitiv i investimeve të investitorëve të vendit dhe të huaj, si dhe nga stimuli fiskal në formën e projekteve publike infrastrukturore.

Produkti i brendshëm bruto, sipas viteve, sipas rajonit, ESC 2010 – Enti Statistikor i Maqedonisë

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
	PBB në million denarë	PBB në million denarë	PBB në million denarë	PBB në million denarë	PBB në million denarë	PBB në million denarë	PBB në million denarë
Republika e Maqedonisë	437 296	464 187	466 703	501 891	527 632	558 954	594 795

Burimi: Enti Statistikor i Maqedonisë
(<http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/?rxid>)

Sipas Entit Statistikor Shtetëror të Republikës së Maqedonisë, PBB-ja në vitin 2014 shënon 525, 620 milion denarë, dhe në krahasim me vitin 2013 në mënyrë nominale është rritur për 4,7%. Rritja reale në krahasim me vitin 2013 shënon 3,5%. Në dhjetor të vitit 2014, prodhimi industrial shënon rritje prej 0,7% në krahasim me muajin dhjetor të vitit 2013. Analizuar nëpër sektorë, prodhimi industrial është prej 2,7%, përderisa në sektorët e minierave, energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar vërehet ulje prej 6,6%, respektivisht 5%.

Në kuartalin e katërt të vitit 2015, në krahasim me të njëjtin periudhë të vitit 2014, PBB-ja shënoi rritje reale prej 3,9%, çka do të thotë se rritja e PBB në vitin 2015 shënon 3,7%.

2.2.1 Perspektiva dhe Rreziqe

Ritmet e rritjes ekonomike pritet të përshpejtohen në 3.5 për qind në vitin 2019 dhe të vijojë në 4.0 për qind në vitin 2020. Parashikimet e rritjes supozojnë se pasiguritë politike të zgjidhen në fillim të vitit 2017, çka do të përmirësojë besimin e konsumatorëve dhe investitorëve privatë. Deficiti fiskal pritet të mbetet në nivel të konsiderueshëm prej 3.2 për qind e PBB-së në vitin 2018, por pastaj të bjerë gradualisht në 2.3 për qind në vitin 2019.

Si rezultat, borxhi publik dhe publikisht i garantuar pritet të rritet në 55 për qind rreth vitit 2019 (nga të cilat 13 pp parashikohet të jenë garanci). CAD në 2017-2019 pritet të jetë mesatarisht 2.6 për qind e PBB-së, i ndikuar nga konsumi dhe kërkesa për investime.

Ruajtja e rritjes ekonomike do të kërkojë një zhvendosje nga stimuli fiskal afatshkurtër në përshpejtimin e reformave strukturore. Një program solid, i besueshëm konsolidimifiscal do të ndihmojë për të stabilizuar borxhin publik dhe për të rindërtuar amortizatorët fiskalë kundër goditjeve. Përveç kësaj, një vlerësim i kostove fiskale dhe kthimit ekonomik të politikave dhe propozimeve të investimeve të kohëve të fundit do të ndihmojë qeverinë për të përcaktuar prioritetet dhe renditur iniciativat esaj për të promovuar në mënyrë më efikas rritjen ekonomike, duke mbajtur në të njëjtin kohë një nivel të menaxhueshëm të borxhit. Rritja në të ardhmen do të varet ngapërshpejtimin e reformave strukturore për të përmirësuar mjedisin e biznesit, aftësitë e forcës së punës, dhe menaxhimin e investimeve publike. Rreziku kryesor në kahun e poshtëmpër perspektivën ekonomike është se pasiguria e vazhdueshme politike do të dëmtojë edhe mëtej besimin e konsumatorit dhe investitorëve privatë dhe do të shtyjë zbatimin e reformave të nevojshme strukturore. Gjithashtu, rrezik të konsiderueshëm për ekonominë paraqesin

edherreziqet e jashtme të lidhura me ngadalësiminekonomik në Eurozonë, partneri kryesor tregtardhe iinvestimeve.

2.3Eksportet - Republika e Maqedonisë dhe Ballkani Perëndimor

Serbia i tejkalon shumë vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor sa u përket eksporteve të mallrave dhe të shërbimeve në këtë periudhë, duke llogaritur rreth 50 përqind të totalit; e pasuar nga Bosnja me 17 përqind, Maqedonia me 14 përqind dhe Shqipëria me 10 përqind. Malii Zi dhe Kosova kanë eksportuar më pak krahasuar me vendete tjera të Ballkanit. Perëndimor, e që përbëjnë vetëm 5 përqind dhe 4 përqind të totalit, respektivisht. Keni parasysh se edhe në Malin e Zi, madhësia e popullsisë dhe e ekonomisë janë të rëndësishme. Për ta kompensuar madhësinë e popullsisë dhe atë ekonomike, në pjesën tjetër, si në rastin e IHD-ve, do të krahasohen në mënyrë të detajuar vendete Ballkanit Perëndimor përmes dy treguesve të eksportit, domethënë eksportet në PBB dhe eksportet për kokë banorë.


Maqedonia, Serbia dhe Malii Zi kanë qenë vendet më të integruara të Ballkanit Perëndimor gjatë pesë viteve të fundit, ku eksportet e mallrave dhe të shërbimeve përbënin rreth 47 përqind, 44 përqind dhe 42 përqind të PBB. Të njëjtat vende prijnë në raport me eksportet për kokë banori, me një ndryshim të vendeve ndërmjet Maqedonisë dhe Malit të Zi. Mesatarisht, eksportet për kokë banori në Mal të Zi kanë arritur në 2,851.3 USD, në Serbi 2,497.7 USD, dhe në Maqedoni 2,375.4 USD. Gjatë viteve të fundit, falë reformave të orientuara kah sektori privat, procedurave tatimore dukshëm të thjeshtuara, reformave në administratën publike dhe në NSH-të, përmirësimit të kadastrës, racionalizimit të lejeve të ndërtimit, konsolidimit fiskal, si dhe stimujve financiarë (subvencionet për investitorët strategjikë), Serbia ka përjetuar një rritje të fortë të bazuar gjerësisht në eksport, veçanërisht të nxitur nga flukset e kohëve të fundit të IHDve në prodhim (industria e automobilave, në mënyrë të veçantë). FIAT-i ka qenë eksportuesi më i madh individual me 1.5 miliardë USD,²⁷ që përbën rreth 8 përqind të totalit të eksporteve e tanishme. Eksportii shërbimeve, i dominuar nga turizmi dhe transporti, ka luajtur rol në eksportet e vendit, duke përbërë mbi 25 përqind të totalit të eksporteve. Për Serbinë, BE-ja ka qenë destinacion më i madh i eksportit, duke llogaritur më shumë se 60 përqind të eksporteve, e pasuar nga CEFTA (mesatarisht, rreth 10 përqind) dhe Rusia (mesatarisht, më pak se 8 përqind).

Maqedonia u karakterizua gjithashtu nga një rritje e vazhdueshme e eksporteve në përgjithësi. Kjo, ndër të tjera, u nxit nga tërheqja e IHD-ve në sektorin e prodhimit si rezultat


ipolitikave të favorshme stimuluuese. Eksportet e mallrave përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 90 përqind të totalit të eksporteve. Potenciali për eksportet shtesë u pengua nga informaliteti - që nga ana e vet ndikoi në konkurrueshmërinë e ndërmarrjeve private. Destinacioni kryesor i eksportit ka qenë BE-ja, që përbënte nga 60-70 përqind të totalit të eksporteve gjatë viteve të fundit. Vlen të theksohet se gjatë këtyre viteve, si Serbia ashtu edhe Maqedonia e kanë rritur proporcionin e produkteve për të cilat duhen aftësi të larta dhe të mesme, si dhe ato me teknologjiintensive përmes pjesëmarrjes në zinxhirët e vlerave evropiane. Kjo u ka ndihmuar këtyre vende në zgjerimin e pjesëmarrjes së eksporteve në BE. Një tendencë e dukshme gjatë viteve të fundit në të dyja vendet është krijimi i ndërmarrjeve dhe përgatitja e punëtorëve të kualifikuar që ofrojnë komunikim, informacion, dhe shërbime kompjuterike për tregjet e eksportit, ndonëse këto mbeten në nivel të ulët. Malii Zi, për dallim nga shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor (përveç Kosovës), shumicën e eksporteve të saj e bazon në shërbime, me mbi 80 përqind gjatë pesë viteve të fundit. Riviera e Malit të Zi tërheq shumë turistë, duke e bërë këtë sektor kontribuuesin më të madh të eksporteve të vendit.

(Përbërja e rritjes reale të BPV-së, përqind)

2016



2017f



Burimi: Bankat Qendrore dhe Zyrat Kombëtare të Statistikave, vlerësimet e stafit të Bankës Botërore.

Rusia dhe Serbia janë dy konsumatorët kryesorë të turizmit në Mal të Zi. Pjesëmarrja në eksportin e mallrave, sidomos e metaleve me ngjyra (e aluminit), po pakësohet gjatë viteve të fundit. Kjo është kryesisht për faktin se kompania më e madhe e prodhimit të aluminit, d.m.th. KAP, ka falimentuar, si dhe për shkak të rënies së çmimeve të metaleve me ngjyra. Kjo rënie u kompensua nga rritjet e regjistruara në sektorin e shërbimeve. Ndërmarrjet në Malin e Zi kanë kosto të larta për të importuar, gjë që gjithashtu përkthehet në pengesa ndaj eksportit. Pikërisht,

një ndërmarrjeje malazeze, mesatarisht i duhen 33 orë dhe 406 USD, për t'iimportuar mallrat e saj. Fytet e ngushta (pengesat) në mjedisin e biznesit, duke përfshirë: zgjidhjen e paaftësisë paguese, zbatimin e kontratave, lejet e ndërtimit - për të përmendur disa, përbëjnë disa nga faktorët që e kanë penguar Malin e Zi në rritjen e bazës së vet të eksportit, posaçërisht të eksportit të mallrave. Bosnja dhe Hercegovina dhe Shqipëria janë dy vendet në vijim të Ballkanit Perëndimor në lidhje me dy treguesit e eksportit.


Në të parin, pjesëmarrja e eksporteve në PBB ka qenë rreth 34 përqind dhe eksporti në PBB mesatarisht rreth 1,657 USD; ndërsa në këtë të dytin, 31 përqind dhe 1,212.5 USD. Eksportet e Bosnja dhe Hercegovinës të mallrave dhe të shërbimeve po ashtu kanë përfituar nga kërkesa e jashtme në rritje. Në përgjithësi, sa u përket dy treguesve, Bosnja dhe Hercegovina ka përjetuar një trend pozitiv të eksporteve. Eksportet e mallrave (të nxitura nga produktet ushqimore, të drurit, ato kimike si dhe pajisjet mekanike) përbëjnë pjesën më të madhe, me një mesatare prej më shumë se 95 përqind.

Destinacionet kryesore të eksportit për eksport të mallrave janë BE-ja (mbi 70 përqind) dhe CEFTA (mbi 10 përqind). Të dyja, eksportii mallrave dhe i shërbimeve kanë përfituar nga kërkesa e jashtme në rritje si dhe rritja e pjesëmarrjes në zinxhirët e vlerave të BE-së. Shqipëria ka përjetuar disa luhatje sa u përket eksporteve gjatë viteve të fundit. Çmimet e ulëta të naftës së papërpunuar dhe të tekstileve, që përbëjnë eksportet kryesore të Shqipërisë, kanë ndikuar në zvogëlimin e fitimeve nga eksporti. Nga ana tjetër, shërbimet e forta (kryesisht turizmi), ndihmuan në baraspeshojnë zvogëlimin në eksportet e mallrave. Vlen të përmendet se Shqipëria ka bërë disa përparime sa i përket konsolidimin fiskal dhe disa reforma të tjera strukturore, të cilat në një farë mase i kanë lehtësuar eksportet. Përkundër të gjitha përpjekjeve, megjithatë, një pjesë e madhe e ndërmarrjeve shqiptare, rreth 87 përqind ende kanë mbetur lokale.

Sa u përket destinacioneve të eksportit, ngjashëm me Serbinë, Maqedoninë dhe Bosnje dhe Hercegovinën, BE-ja është destinacioni kryesor, e pasuar nga vendet e CEFTA-s. Kosova zë vendin më të ulët nga të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor në raport me eksportet. IHD-të, në vend se të jenë burim i madh i rritjes së eksporteve, janë të orientuara kah sektori shërbimeve, kryesisht pasuritë e patundshme dhe sektori financiar; këta sektorë për nga natyra e tyre nuk mund të kenë rol të drejtpërdrejtë në rritjen e eksporteve.

Baza e ulët industriale dhe si rrjedhojë pjesëmarrja e ulët e eksporteve të mallrave e pengojnë integrimin e ndërmarrjeve të Kosovës në rrjetet e biznesit dhe zinxhirët e vlerave

globale. Eksportuesit e Kosovës ballafaqohen me pengesa të natyrave të ndryshme. Një ilustrim tipik është fakti që një firmë të Kosovës i duhet të presë 43 orë për pajtueshmërinë nga kufiri dhe 38 orë të tjera për përputhshmërinë me dokumentacionin. Mesatarja në pesë vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor është 7 orë dhe 3.8 orë. Përveç kësaj, një ndërmarrje nga Kosova duhet të paguajë 264 USD për eksport, krahasuar me një mesatare prej 72 USD në pesë vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Përveç tjerash, qasja e kufizuar në financa, teknologjia e vjetruar, qasja e kufizuar në informatat mbi tregun e eksportit, mungesa e standardeve të cilësisë dhe të menaxhimit, paraqesin disa arsye të tjera që ndikojnë në konkurrueshmërinë e ndërmarrjeve të Kosovës dhe si të tillë në aftësinë e tyre për të eksportuar.



Burimet: Banka Botërore (në botim 2017) "Ballkani Perëndimor: Ndezja e motorëve të Rritjes dhe Prosperitetit Ekonomik". Banka Botërore. Washington DC.; Banka Botërore (2012) "Rritja e Artë Ekonomike: Rikthimi i Famës së Modelit Ekonomik Evropian", Banka Botërore. Washington DC.; Banka Botërore (2016) "Ribalancim për Rritje më të Fortë Ekonomike", RRE Nr.9 për Evropën Juglindore, Banka Botërore, Washington DC.; Banka Botërore (2017) Ballkani Perëndimor: Shënime për Çështje të Integrimit Ekonomik Rajonal, Banka Botërore, Washington DC.; WITS, CIA Factbook, dhe vlerësime të Stafit të Bankës Botërore.

Nëse merret Ballkani Perëndimor si tërësi, është e qartë se marrëveshja CEFTA-s dhe marrëveshjet e MSA-së (dhe marrëveshjet e mëparshme tregtare me BE-në) i kanë lehtësuar eksportet ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe në BE. Megjithatë, ende duhet të ndërmerren veprimet pakësuese për t'i reduktuar barrierat jo-tarifore që janë shumë të

pranishme. Duhet theksuar se këto marrëveshje nuk e trajtojnë qasjen në treg të tregtisë në shërbime, në këtë mënyrë paraqesin pengesë për kompanitë e shërbimit. Në përgjithësi, ekonomia e ngadalshme globale mund t'i ndërlikojë përpjekjet për rritjen e eksportit. Nga ana tjetër, kjo mund të krijojë edhe mundësi për vendet e Ballkanit Perëndimor, për shkak se firmat ndërkombëtare që kanë tregje, teknologji, dhe kapital do të jenë të gatshme që të zhvendosen për ta përmirësuar konkurrueshmërinë e tyre.

III. KAPITULLI TRETË

Pjesa empirike e studimit

3.1 Mënyrat e të studijuarit të ndikimit të Eksportit në Rritjen ekonomike

Integrimet ndërkombëtare të tregjeve kanë nxitur gjithnjë kompanitë të marrin pjesë në bizneset ndërkombëtarë, jo vetëm në shkëmbimet tregtare të mallrave dhe shërbimeve, por edhe në transferim të kapitalit, duke çuar në lindjen e eksportit. Teoritë ekonomike mbieksportin Ishikojnë këto investime me ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen ekonomike të vendeve pritës, duke u analizuar si një faktor “input” në këto ekonomi, d.m.th hyrje kapitali, teknologjie, etj. Empirikisht modelet e para që bëjnë këtë interpretim janë sipas teorisë neoklasike të rritjesendogjene të ekonomisë së një vendi, të shprehur në çështjen më lart. Sipas këtyre studimeve janë përdorur gjerësisht testime statistikore që vlerësojnë lidhjen midis eksportit dhe rritjes ekonomike. Me zhvillimet e metodave të testimeve ekonometrike, programeve kompjuterike, pas viteve 90-të kjo qasje neoklasike filloi të vlerësohet për ekonomi të vendeve të ndryshme (në zhvillim dhe të zhvilluara).

Metodat e vlerësimit kanë qenë të ndryshme, ku më të përdorura janë: modelet e regresioneve të shumëfishta sipas vlerësimit me metodën e katrorëve më të vegjël; analizat shkaksore Granger; lidhjet afatgjata (Kointegrimi); modele me vector autoregresiv (VAR); analiza dhe korrigjime të mbetjeve; metoda e përgjithshme e momenteve (GMM); modele regresioni dy-fazore (2SLS); modelevlerësimi të lidhjeve të fshehta (SUR); etj. të gjithë këto modele synonin të identifikonin lidhjet e eksportit me PBB ose rritjen ekonomike. Sipas shumë studimeve ka rezultuar që eksportet shkaktojnë ose ndikojnë pozitivisht në rritjen ekonomike të vendeve pritëse. Porekzistojnë edhe disa raste që shprehen për lidhje negative të eksporteve me rritjen ekonomike të vendeve pritëse.

Këto metoda dhe përfundime janë bazuar në të dhëna të serive kohore të treguesve të ndryshëm makroekonomik dhe të dhëna panel për vende në zhvillim nga Azia, Afrika, Amerika Latine, Evropë dhe vende të zhvilluara. Për të përmbledhur këto përfundime nga studime të bëra, rishikimin e literaturës në lidhje të eksportit dhe rritjes ekonomike që janë publikuar 2-3 dekadat e fundit .

Bazuar në studime të autorëve të ndryshëm, ekzistojnë edhe analiza sasiore, që janë të mendimit që eksportet ose nuk kanë efekt në rritjen ekonomike (ose kanë një efekt shumë të dobët lidhje) ose në rastin më të keq kanë edhe lidhje negative me rritjen ekonomike të vendeve pritëse. Në të vërtetë në kontekstin përgjithësues të literaturës këto studime shikohen me kureshtje, ndonëse përfaqësojnë zërin kritik të eksporteve në rritjen ekonomike dhe përbëjnë nivelin më të vogël të studimeve në këtë qëndrim ekonomik.

3.2 Shpërndarja e vlerave makroekonomike të Republikës së Maqedonisë prej 2001-2016

Duke u nisur nga objektii kërkimit ky hulumtim aplikon metoda të ndryshme shkencore për të pranuar ose hedhur poshtë hipotezat e parashtruara. Në fakt në hulumtimet e shkencave shoqërore janë të njohura dy lloj qasjesh: deduktive dhe induktive. Me qasjen deduktive, nga teoritë dhe hipoteza që janë zhvilluar hartohet një strategji kërkimore për të testuar hipotezat. Ndërsa nga ana tjetër, me qasjen induktive nga mbledhja e të dhënave shkohet deri tek zhvillimii teorive duke u bazuar në rezultatet nga analiza e të dhënave.

Në këtë studim janë përdorur qasja deduktive, duke testuar hipotezat e ngritura mbi hulumtimet e mëparshme për lidhjen kauzale midis variablave kundrejt realitetit, duke u nisur vetëm nga disa supozime. Për ti arritur objektivat e këtij hulumtimi, është ndërmarrë rishikimii një literature të gjerë si: shqyrtim i kërkimeve të mëparshme në këtë fushë të studimit, punime magjistrature, artikuj të ndryshëm shkencor, raporte, tabela statistikore, baza të dhënash në internet etj. që fokusohen në shpjegimin e investimeve të huaja direkte dhe rritjes ekonomike.

Pasi që qëllimii këtij studimi është të sigurojë prova empirike për raportin e eksportit në rritjen ekonomike dhe të analizojë lidhjen që ekziston midis tyre, ishte e arsyeshme të bërit e një sqarimi mbi metodat e hulumtimit me të cilat do të zhvillohen operacionet e kërkimit. Kjo do të na mundësojë që të identifikojmë dhe të marrim njohuri rreth kësaj veprimtarie studimore për të përcaktuar lidhjen që ekziston në mes variablave.

Në mbledhjen e të dhënave u përdorën teknikat e mëposhtme: analiza e përmbajtjes së dokumenteve, materiale të kërkimeve të mëparshme, përpunime statistikore, kërkime të dhënash nga institucione ndërkombëtare dhe ato vendase, me synim që këto të dhëna të jenë në përputhje me objektivat e studimit. Në testimin e hipotezave u përdorën: Granger Causality Test,

testi Augmentet Dikey Fuller (ADF) duke përfshirë Analizën e regresionit, metodën e koeficienteve të ndryshëm të korelacionit.

Siç e cekëm edhe tek projekti i ideor i hulumtimit se qëllimi kryesorë i këtij studimi përfshinë ndikimin e eksportit në zhvillimin e një shteti në përgjithësi e në veçanti analizën e lidhjes kauzale të eksporteve mbi rritjen ekonomike në Republikën e Maqedonisë. Pra, problemii hulumtimit është përcaktimii lidhjes në mes eksportit dhe rritjes ekonomike duke përshkruar, analizuar dhe vlerësuar lidhjen kauzale ndërmjet eksporteve dhe rritjes ekonomike në Maqedoni.

Për tu patur më qartë, më poshtë i paraqesim të dhënat makroekonomike për ekonominë e Maqedonisë duke potencuar Investimet e Huaja Direkte (IHD), Produktin Bruto Brendshëm (PBB), Punësimin, Papunësinë, Eksportet, Importet, Inflacionin, Konsumin e Qeverisë, dhe kapitalin Human edhe ate prej 2001 e deri më 2016 kur edhe mund të gjejmë të dhëna konkrete dhe zyrtare nga ana e entit statistikor të Maqedonisë apo nga Banka Popullore të Republikës së Maqedonisë.

Tabela 1. Të dhënat makroekonomike të republikës së Maqedonisë prej viti 2001-2016

Viti	IHD (% në PBB)	PBB	PBB për kokë banori	Punësimi	Papunësia	Eksportet	Importet	Inflacioni	Konsumi Qeverisë	Kapitali Hu man
2001	12.0	-4.5	3400	42.6	30.5	\$1,157,506,515	\$1,693,600,813	3.7	-5.9	13.1
2002	2.6	.9	3455	40.4	31.9	\$1,115,526,926	\$1,995,155,885	1.1	-5.2	4.3
2003	2.4	2.8	3542	38.5	36.7	\$1,366,988,742	\$2,306,353,206	2.6	-1.0	7.0
2004	5.7	4.7	3600	36.8	37.2	\$1,675,877,228	\$2,931,626,088	-1.9	.0	2.0
2005	1.5	4.7	3765	37.9	37.3	\$2,042,295,799	\$3,232,837,357	1.2	.2	6.4
2006	6.2	5.1	3806	39.6	36.0	\$2,415,160,898	\$3,752,256,230	2.9	-.5	17.9
2007	8.4	6.5	4200	40.7	34.9	\$3,398,268,282	\$5,280,584,019	6.1	.6	30.7
2008	6.1	5.5	4333	41.9	33.8	\$3,990,642,488	\$6,882,653,384	4.1	-.9	14.5
2009	2.0	-.4	4432	43.3	32.2	\$2,708,487,570	\$5,072,820,972	-1.6	-2.6	-3.5
2010	2.2	3.4	4550	43.5	32.0	\$3,351,429,481	\$5,474,484,884	3.0	-2.4	9.8
2011	4.5	2.3	4887	43.9	31.4	\$4,478,313,344	\$7,027,162,308	2.8	-2.5	6.9
2012	1.7	-.5	4912	44.0	31.0	\$4,015,416,864	\$6,522,387,659	4.7	-3.8	7.6
2013	2.8	2.9	5128	46.0	28.6	\$4,298,771,673	\$6,619,586,359	1.4	-3.8	6.2
2014	2.3	3.6	5625	46.0	27.6	\$4,964,132,180	\$7,301,370,314	-.5	-4.2	22.2
2015	2.3	3.8	4882	47.8	27.3	\$4,530,076,667	\$6,426,812,386	-.4	-3.5	18.4
2016	2.1	2.9	5210	46.2	23.7	\$4,784,604,593	\$6,256,412,376	-.2	-2.2	17.2


Burimi: Enti Statistikor dhe Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë (28.12.2018)

Tek tabela 2 më poshtë janë parashtruar parametrat deskriptive të variablës së Produktit Bruto të Brendshëm (PBB), PBB-së për kokë banori pra, këto dy variabla apo parametra që përcaktojnë nivelin e zhvillimit të ekonomisë së vendit dhe nga ana tjetër variablën kryesore të hulumtimit eksportit periudhën 2001-2016 dhe sipas të dhënave apo më saktë sipas renditjes së mesatares, medianës dhe modës mund të konstatojmë se shpërndarja e këtyre të dhënave më saktë variabla e PBB-së ka shpërndarje asimetrike negative përkundër PBB-së për kokë banori që (mesatarja dhe mediana janë të përafërta) shfaq një shpërndarje më pak asimetrike por me trend pozitiv si dhe shpërndarja e variablës së eksporteve poashtu shfaqet në këtë formë me trend të rritjes pozitive.


Tabela 2. Statistikat deskriptive të shpërndarjes së PBB, PBB për kokë banori dhe Eksportit në Republikën e Maqedonisë prej 2001-2016

	PBB	PBB për kokë banori	Eksportet
Mesatare	2.731	4357.94	\$3,143,343,703.12
Mediana	3.150	4382.50	\$3,374,848,881.50
Moda	2.9 ^a	3400 ^a	\$1,115,526,926 ^a
Minimum	-4.5	3400	\$1,115,526,926
Maximum	6.5	5625	\$4,964,132,180


Për një vizualitet më të qartë po paraqesim këto shpërndarje më poshtë në forma grafike:




Grafiku 1. Produkti Bruto i Brendshëm i Republikës së Maqedonisë prej 2001-2016




Grafiku 2. Produkti Bruto i Brendshëm për kokë banori i Republikës së Maqedonisë prej 2001-2016



Një këndvështrim më të qartë që e potencon një ndërlidhje mes këtyre dy variableve apo parametrave makroekonomik pra, mes PBB-së dhe eksporteve si dhe PBB-së për kokë banori dhe eksporteve do të pasqyrojmë me dy grafikonet e ardhshme kun ë boshtin horizontal pasqyrohen të dhënat e eksportit në dollarë si dhe tek boshti vertikal pasqyrojmë të dhënat për PBB-në gjegjësisht PBB-në për kokë banori (grafiku 4 dhe 5):




Edhe pse qartë paraqiten vlerat e të dy variablave tek grafiku 4 më sipër pra, të PBB-së dhe eksportit në Republikën e Maqedonisë prej 2001-2016 nuk mund të potencohet trendi statistikor e më pak edhe ndërlidhja midis këtyre variablave, prandaj analizat e mëtutjeshme statistikore konkluzive do të trajtojnë një ndërlidhje potenciale mes këtyre dy variablave.




Grafiku 5. Ndërlidhja mes vlerës së eksporteve dhe PBB për kokë banori në Republikën e Maqedonisë prej 2001-2016

Përkundër paqartësisë të përcaktimit të trendit të lidhshmërisë tek grafiku 4 më sipër tek grafiku 5 ku parashtrihen vlerat për PBB për kokë banori dhe vlerat e eksportit këtu qartë shihet se ndërlidhja mes këtyre variablave ka trend statistikor rritës pozitiv dhe me analizat e mëtutjeshme statistikore konkluzive do të mund të përcaktohet edhe niveli i ndërlidhjes apo fuqia e ndërlidhshmërisë midis këtyre dy variablave.

Poashtu për ty patur më qartë edhe parametrat tjerë të ekonomisë së Maqedonisë do të parashtrijmë në forma grafike trendet e papunësisë, inflacionit dhe kapitalit human si baza dhe vlera kyçe për nivelin e zhvillimit të ekonomisë së Maqedonisë dekadat e fundit (grafiku 6 më poshtë):



Grafiku 6. Papunësia, Inflacioni dhe niveli i Kapitalit Human në Republikën e Maqedonisë prej 2001-2016



Grafiku 7. Ndërlidhja e nivelit të papunësis dhe vlerës së eksportit në Republikën e Maqedonisë prej 2001-2016

Te grafiku 7 poashtu pasqyrojmë edhe ndërlidhjen potenciale mes vlerave të eksportit dhe nivelit të papunësisë ku qartë mund të potencohet ekzistimin e një ndërlidhjeje mes këtyre dy variablave edhe ate me rritjen e nivelit të eksportit ulet vlera e paunësisë në Republikën e Maqedonisë dekadate fundit, por fuqinë apo mënyrën e ndërlidhjes do të përcaktojmë më poshtë me satatistikat konkluzive ekonomike.

3.3 Statistikat konkluzive ekonomike dhe interpretimii hipotezave

Siç potencuam edhe më sipër, për të vlerësuar tipin dhe fuqinë e ndërlidhjeve potenciale mes variables së eksportit dhe vlerave tjera makroekonomike si tregues për zhvillimin e ekonomisë së Republikës së Maqedonisë, në vazhdim do ti përdorim metodat e korelacionit midis këtyre variablave të parashtruara më poshtë tek tabela 3:

Tabela 3. Korelacioni ndërmjet parametrave makroekonomik dhe eksportit në Republikën e Maqedonisë prej 2001-2016

Eksportet		
PBB	Pearson Correlation	.286
	Sig. (2-tailed)	.283
	N	16
PBB per capita	Pearson Correlation	.955
	Sig. (2-tailed)	.000
	N	16
Punësimi	Pearson Correlation	.792
	Sig. (2-tailed)	.000
	N	16
Papunësia	Pearson Correlation	-.662
	Sig. (2-tailed)	.005
	N	16
Importet	Pearson Correlation	.975
	Sig. (2-tailed)	.000
	N	16
Inflacioni	Pearson Correlation	-.018
	Sig. (2-tailed)	.949
	N	16
Kapitali Human	Pearson Correlation	.404
	Sig. (2-tailed)	.121
	N	16

Sipas koeficientëve të fituara të korelacionit të Pearson-it qartë shihet se ekzistojnë ndërlidhje të fuqishme (korelacion shumë i lartë pozitiv) mes variables së eksportit dhe PBB-së për kokë banori edhe atë $r=0.955$ me sinjifikancë prej $0.000<0.01$ pra më e vogël nga kufiri i parë i besueshmërisë me fjalë tjera themi se me rritjen e nivelit të eksporteve rezulton rritje të vlerës së PBB-së për kokë banori dhe e kundërta.

Më pas, poashtu ekziston korelacion të lartë pozitiv mes vlerave të eksportit dhe koeficientit të punësimit edhe atë $r=0.792$ me koeficientë të rëndësishëm të sinjifikancës prej $0.000<0.01$ pra më e vogël nga kufiri i parë i besueshmërisë me fjalë tjera themi se me rritjen e nivelit të eksporteve rezulton rritje e shkallës së punësimit dhe e kundërta. Poashtu, sipas logjikës hulumtuese është e pritshme edhe koeficienti i korelacionit të lartë por negative mes vlerës së eksportit dhe shkallës së papunësisë, pra, $r=-0.662$ me sinjifikancë poashtu prej $0.005<0.01$ pra më e vogël nga kufiri i parë i besueshmërisë me fjalë tjera themi se me rritjen e nivelit të eksporteve rezulton ulje e shkallës së papunësisë dhe e kundërta.

Poashtu vlen të potencohet edhe ndërlidhja e fuqishme pozitive mes vlerave të eksportit dhe vlerave të importit me $r=0.975$ me sinjifikancë prej $0.000<0.01$ pra më e vogël nga kufiri i parë i besueshmërisë me fjalë tjera themi se me rritjen e nivelit të eksporteve rezulton rritje e vlerës së importeve në vend dhe e kundërta.

Analizat e rradhës e vazhdojmë me analizat e regresionit linear apo me fjalë tjera thënë ndikimin e një grup faktorëve (PBB, PBB për kokë banori, Papunësisë, Inflacionit dhe Kapitalit human) tek një variabël (Eksporti).

Tek tabela 4 më poshtë parashtrohet korelacioni i grup faktorëve (PBB, PBB për kokë banori, Papunësisë, Inflacionit dhe Kapitalit human) me eksportin edhe atë $r=0.963$ pra ky grup faktorësh ndërlidhen me eksportin me një lidhje të fuqishme mes tyre.

Tabela 4. Ndikimi i grup faktorëve në vlerën e eksportit (Regresion linear)

Model	R	R Square	Adjusted R Square	Std. Error of the Estimate
1	.981 ^a	.963	.945	\$320,498,729.287

a. Predictors: (Constant), Kapitali_Human, Papunësia, Inflacioni, PBB, PBB për kokë banori

Kjo ndërlidhje e fuqishme mes grup faktorëve të lartpërmendur dhe eksportit tek tabela 5 vërtetohet dhe konfirmohet me koeficientin e sinjifikancës apo rëndësisë për $0.000 < 0.001$ për kufirin e parë të besueshmërisë.

Tabela 5. Koeficientii sinjifikancës për ndikimin e lartpërmendur ANOVA^a

Model		Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
1	Regression	269048543050 03614000.000	5	538097086100 0722400.000	52.385	.000^b
	Residual	102719435474 6201220.000	10	102719435474 620128.000		
	Total	279320486597 49814000.000	15			

a. Dependent Variable: Eksportet

b. Predictors: (Constant), Kapitali_Human, Papunësia, Inflacioni, PBB, PBB për kokë banori

Nëse e veçojmë fuqinë e ndikimit të faktorëve veç e veç nga tabela 6 më poshtë me koeficientet e regresionit linear mund të verifikojmë dhe të vërtetojmë lidhjen dhe fuqinë esaj mes eksportit dhe PBB-së për kokë banori, Papunësisë pra verifikimi e rritjes së eksportit me rritjen e PBB-së për kokë banori (0.840 me sinjifikancë 0.000) dhe verifikimin e uljes së shkallës së papunësisë me rritjen e eksportit (-0.160 me sinjifikancë 0.014).

Tabela 6. Koeficientët e regresionit për ndikimin e secilit faktorë veçmas

Model	Unstandardized Coefficients		Standardized Coefficients	t	Sig.
	B	Std. Error	Beta		
(Constant)	-2600085552.268	2415784509.329		-1.076	.307
PBB	116832904.805	52198222.293	.236	2.238	.049
PBB për kokë banori	1622867.397	221539.285	.840	7.325	.000
Papunësia	-55693512.279	50330158.745	-.160	-1.107	.014
Inflacioni	97472194.986	49733489.114	.165	1.960	.078
Kapitali_Human	-3732434.064	15994763.696	-.023	-.233	.820

a. Dependent Variable: Eksportet

Por nga ana tjetër me anë të metodës së Granger Causality testit për gjetjen e një kauzaliteti midis variablës së eksportit dhe PBB, numrat flasin diçka tjetër, analizat e Granger testit si më poshtë:

Tabela 7. Pairwise Granger Causality Tests (Testii kauzalitetit)

Date: 12/25/18 Time: 20:20			
Sample: 1 15			
Lags: 2			
Null Hypothesis:	Obs	F-Statistic	Prob.
EKSPORTE does not Granger Cause PBB	13	2.42774	0.1500
PBB does not Granger Cause EKSPORTE		0.54674	0.5990

Pra, tek tabela 7 më sipër tek katër rreshtat paraqiten hipotezat zero ku thuhet se Eksporti në fakt vargu serik i të dhënave të Eksportit nuk është e dobishme për të parashikuar ecurinë e vargut serik kohor të variablës PBB dhe anasjelltas, edhe pse këtu gabimi në parashikim është shumë më i vogël se me varijablat tjera 0.15 por prap jo e mjaftueshme për një vlersim sinjifikantë statistikor. Pra, me fjalë tjera Eksporti në këtë hulumtim sipas Granger testit nuk është e dobishme për të parashikuar varijablat tjera të hulumtimit siç janë PBB.

Për arsye të rezultateve të tilla si më sipër, kahja e analizave të mëtutjeshme drejtohet te vetë varijabla apo tek natyra e variablës së Eksportit se vallë ky seri të dhënash është stacionare (të dhënat janë afër drejtëzës) apo jostacionare (të dhënat marrin kahje larg nga drejtëza me trend rritës apo zvoglues) dhe për cilën shkallë, dhe bazë të kësaj a ka trend statistikor dhe për çfarë trendi bëhet fjalë!?

Analizat vazhdojmë me testin ADF (unit root) si më poshtë:

Tabela 8. Null Hypothesis: PBB has a unit root (ADF testi për trendin statistikor për **PBB**)

Exogenous: Constant		
Lag Length: 0 (Automatic - based on SIC, maxlag=3)		
	t-Statistic	Prob.*
Augmented Dickey-Fuller test statistic	-3.748527	0.0158
Test critical values: 1% level	-4.004425	
5% level	-3.098896	

10% level

-2.690439

*MacKinnon (1996) one-sided p-values.

Warning: Probabilities and critical values calculated for 20 observations and may not be accurate for a sample size of 14

Augmented Dickey-Fuller Test Equation

Dependent Variable: D(PBB)

Method: Least Squares

Date: 12/25/18 Time: 20:23

Sample (adjusted): 2 15

Included observations: 14 after adjustments

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
PBB(-1)	-0.709621	0.189307	-3.748527	0.0028
C	2.468284	0.733565	3.364777	0.0056
R-squared	0.539373	Mean dependent var	0.592857	
Adjusted R-squared	0.500988	S.D. dependent var	2.841577	
S.E. of regression	2.007313	Akaike info criterion	4.363035	
Sum squared resid	48.35168	Schwarz criterion	4.454329	
Log likelihood	-28.54124	Hannan-Quinn criter.	4.354584	
F-statistic	14.05145	Durbin-Watson stat	2.000418	
Prob(F-statistic)	0.002778			

Tek tabela 8 në sipër paraqitet hipoteza zero ku thuhet se PBB ka rrënjë unike (unit root) për shkallën „level,, pra domethënë se është jostacionare pa trend statistikor por me poshtë tek t-statistics numri negativ i pari është më i vogël se tri numrat tjera negative dhe me probabilitet $0.01 < 0.0158$ që nuk ka sinjifikancë statistikore pra, nuk mund të hudhim hipotezën zero më sipër se Eksporti është jostacionare dhe mbetet që për shkallën „level,, Eksporti është jostacionare dhe pa trend statistikor, pra, nuk mund të parashikohet se a do të ndikojë edehe në të ardhmen me këtë trend statistikor eksporti PBB apo jo, prandaj do të vazhdojmë analizat tek shkalla tjetër „1st difference,, .

Tabela 9. Null Hypothesis: PBB has a unit root (ADF testi për trendin statistikor për Eksportet)

Exogenous: Constant Lag Length: 1 (Automatic - based on SIC, maxlag=3)	
t-Statistic	Prob.*

Augmented Dickey-Fuller test statistic		-5.509266	0.0012	
Test critical values:	1% level	-4.121990		
	5% level	-3.144920		
	10% level	-2.713751		
*MacKinnon (1996) one-sided p-values.				
Warning: Probabilities and critical values calculated for 20 observations and may not be accurate for a sample size of 12				
Augmented Dickey-Fuller Test Equation				
Dependent Variable: D(EKSPORTE,2)				
Method: Least Squares				
Date: 12/25/18 Time: 20:28				
Sample (adjusted): 4 15				
Included observations: 12 after adjustments				
Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
D(EKSPORTE(-1))	-2.183072	0.396255	-5.509266	0.0004
D(EKSPORTE(-1),2)	0.720571	0.252700	2.851491	0.0190
C	6.01E+08	1.91E+08	3.152345	0.0117
R-squared	0.800343	Mean dependent var	-57126444	
Adjusted R-squared	0.755975	S.D. dependent var	1.06E+09	
S.E. of regression	5.24E+08	Akaike info criterion	43.20488	
Sum squared resid	2.47E+18	Schwarz criterion	43.32610	
Log likelihood	-256.2293	Hannan-Quinn criter.	43.15999	
F-statistic	18.03870	Durbin-Watson stat	1.698004	
Prob(F-statistic)	0.000710			

Tek kjo shkallë (1st difference) në tabelën 6 paraqitet situatë tjetër ku hipoteza zero se Eksporti ka rrënjë unike (unit root) pra jostacionare hudhet dhe nuk pranohet për arsye se numrii parë negativ tek t-statistics është më i madh se numrat negative të tjera më poshtë me një sinjifikancë të rëndësishme statistikore prej $0.0012 < 0.01$, mund të themi dhe të konkludojmë se varijabla e Eksporti është stacionare për shkallën „1st difference,, por pa trend statistikor, me fjalë tjera në shkallën „level,, më sipër Eksporti ka lëvizje të pacaktuar me varijacione dhe pa trend apo parashikueshmëri kohore, kurse për shkallën „1st difference,, Eksporti stacionohet afër drejtëzës (afër mesatares) por pa trend statistikor pra nuk mund të parashihet trendi sipas kohës.

3.5 Diskutimii rezultateve

- ekzistojnë ndërlidhje të fuqishme (korelacion shumë i lartë pozitiv) mes variables së eksportit dhe PBB-së për kokë banori edhe atë $r=0.955$ me sinjifikancë prej $0.000<0.01$ pra më e vogël nga kufirii parë i besueshmërisë me fjalë tjera themi se me rritjen e nivelit të eksporteve rezulton rritje të vlerës së PBB-së për kokë banori dhe e kundërta, pra, sipas hulumtimeve paraprake por edhe nga teoria ekonomike është më se e pritshme kjo ndërlidhje duke u bazuar në atë se eksporti e rritur sjell prodhim të mallrave në vend që eksportohen me atë rritje edhe të punësimit dhe rritja e harxhimeve të populates apo kokë banori. Në këtë drejtim janë edhe konstatimet e Ingraham, Christopher (15 May 2018). "Satellite data strongly suggests that China, Russia and other authoritarian countries are fudging their GDP reports" i cili potencon se ekonomitë e vogla, siç është rasti i Republikës së Maqedonisë, pra zhvillimii ekonomive të tyre në mënyrë direkte ndikohen nga niveli i investimeve të huaja si dhe shkallës së eksportit.
- Më pas, ekziston korelacion të lartë pozitiv mes vlerave të eksportit dhe koeficientit të punësimit edhe atë $r=0.792$ me koeficient të rëndësishëm të sinjifikancës prej $0.000<0.01$ pra më e vogël nga kufirii parë i besueshmërisë me fjalë tjera themi se me rritjen e nivelit të eksporteve rezulton rritje e shkallës së punësimit dhe e kundërta. Poashtu, sipas logjikës hulumtuese është e pritshme edhe koeficienti i korelacionit të lartë por negative mes vlerës së eksportit dhe shkallës së papunësisë, pra, $r=-0.662$ me sinjifikancë poashtu prej $0.005<0.01$ pra më e vogël nga kufirii parë i besueshmërisë me fjalë tjera themi se me rritjen e nivelit të eksporteve rezulton ulja e shkallës së papunësisë dhe e kundërta. Poashtu edhe kjo ndërlidhje është më se e pritshme për ekonominë e Republikës së Maqedonisë për faktin se Maqedonia eksporton kryesisht mallra bujqësore prandaj edhe shpejtë hapen vende të punës të cilat karakterizohen si sezonale si dhe punësimi në industrinë tekstilë që prodhohen veshje për brendet të njohuri botërore të cilat vetëm përdorim punën e dorës së punonjësve në Republikën e Maqedonisë.
- Poashtu vlen të potencohet edhe ndërlidhja e fuqishme pozitive mes vlerave të eksportit dhe vlerave të importit me $r=0.975$ me sinjifikancë prej $0.000<0.01$ pra më e vogël nga kufirii parë i besueshmërisë me fjalë tjera themi se me rritjen e nivelit të eksporteve rezulton rritje e vlerës së importeve në vend dhe e kundërta. Ky fakt është poashtu e njohur për arsye se Republika e Maqedonisë është konsumues i shumë mallrave esenciale

jetësore për shkak të industrisë së dobët e zhvilluar si dhe industrisë teknologjike të pazhvilluar fare.

- korelacionii grup faktorëve (PBB, PBB për kokë banori, Papunësisë, Inflacionit dhe Kapitalit human) me eksportin edhe atë $r=0.963$ pra ky grup faktorësh ndërlidhen me eksportin me një lidhje të fuqishme mes tyre. Vërtetojmë lidhjen dhe fuqinë esaj mes eksportit dhe PBB-së për kokë banori, Papunësisë pra verifikimi e rritjes së eksportit me rritjen e PBB-së për kokë banori (0.840 me sinjifikancë 0.000) dhe verifikimin e uljes së shkallës së papunësisë me rritjen e eksportit (-0.160 me sinjifikancë 0.014). Sa i përket ndikimit të eksportit në papunësinë e Republikës së Maqedonisë gjatë kësaj periudhe kohore, shohim një lidhje negative midis tyre, çka do të thotë se me rritjen e eksportit për 1 milion euro, papunësia ulet me 0,01%. Kjo lidhje na tregon mbi rëndësinë e nxitjes së eksportit të produkteve vendore për reduktimin e normës së papunësisë në Republikën e Maqedonisë. Nga ana tjetër, importi ka një lidhje pozitive me normën e papunësisë në Republikën e Maqedonisë, kështu që me rritjen e importit për një milion dollarë, norma e papunësisë rritet me 0,01%.
- Eksporti në këtë hulumtim sipas Granger testit nuk është e dobishme për të parashikuar variablat tjera të hulumtimit siç janë PBB.
- nuk mund të parashikohet se a do të ndikojë edhe në të ardhmen me këtë trend statistikor eksporti PBB apo jo, prandaj do të vazhdojmë analizat tek shkalla tjetër „1st difference,, .
- mund të themi dhe të konkludojmë se variabla e Eksporti është stacionare për shkallën „1st difference,, por pa trend statistikor, me fjalë tjera në shkallën „level,, më sipër Eksporti ka lëvizje të pacaktuar me varijacione dhe pa trend apo parashikueshmëri kohore, kurse për shkallën „1st difference,, Eksporti stacionohet afër drejtëzës (afër mesatares) por pa trend statistikor pra nuk mund të parashihet trendi sipas kohës.

IV. KAPITULLI KATËRT

Përfundimi dhe rekomandime

4.1 Përfundimi

Politikat makroekonomike zbatohen në mënyrë që të arrihen objektivat kryesore të qeverisë për punëzënie të plotë dhe ekonomi të qëndrueshme me inflacion të ulët papunësi të ulët. Objektivikryesor i çdo programi ekonomik është që të arrijë një rritje të qëndrueshme ekonomike nëpërmjet eksportit dhe importit menjë normë të ulët të inflacionit dhe papunësisë. Papunësia dhe inflacioni kanë qenë dhe do tëmbeten gjithmonë preokupimi kryesor i çdo politike ekonomike.

Nga ana tjetër, duke u referuar qëllimit kryesor të kësaj teze që është së përshkruri, analizuari dhe vlerësuar lidhjes kauzale ndërmjet shkallës apo nivelit të eksportit dhe rritjes ekonomike në Republikën e Maqedonisë në periudhën prej vitit 2001 deri në vitin 2017 si dhe duke parë rëndësinë e këtyre treguesve makroekonomikë, qëllimii veçantë i këtij punimi është që të analizojë lidhjen dhe ndikimin e shkallës së eksportit ndaj rritjes ekonomike në Republikën e Maqedonisë.

Pra, mund të themi dhe të konkludojmë se ky qëllim u arrit duke analizuar fillimisht pjesëmarrjen e shkallës së eksportit në Republikën e Maqedonisë dhe më pas analizatqë të njëjtat do ndikojnë në mënyrë signifikante në rritjen ekonomike duke studiuar treguesit kryesor të rritjes ekonomike siç janë: PBB, nivelin dhe ecurinë e punësimit, inflacionit, etj.

Tani nëse referohemi hipotezës kryesori të hulumtimit ku potencohet *H1: Nuk ka ndikim signifikant midis shkallës së eksportit dhe rritjes ekonomike në Republikën e Maqedonisë*mund të konstatojmë se hipoteza kryesore e hulumtimit nuk qëndron dhe nuk verifikohet pasi u konstatua se ekziston ndërlidhje e fortë mes eksportit dhe rritjes ekonomike të Republikës së Maqedonisë sidomos mes parametrave të PBB-së për kokë banori dhe shkallës së papunësisë, pra, me rritjen e nivelit të eksporteve rezulton rritje të vlerës së PBB-së për kokë banori dhe e kundërta, me rritjen e nivelit të eksporteve rezulton rritje e shkallës së punësimit dhe e kundërta, me rritjen e nivelit të eksporteve rezulton rritje e vlerës së importeve në vend dhe e kundërta dhe Eksporti në këtë hulumtim sipas Granger testit nuk është e dobishme për të parashikuar ndikimin e saj në PBB e Republikës së Maqedonisë në të ardhmen.

4.2 Rekomandime

Përmirësimi pozitës së eksporteve të Republikës së Maqedonisë në konkurrencë do të kërkojë investime në infrastrukturë, përmirësime të legjislacionit dhe forcim të kapacitetit institucional duke përfshirë:

- Investimin në infrastrukturën e transportit për tu përballur me kërkesat në rritje;

- Rritja e efikasitetit të infrastrukturës institucionale që merren me tregti;

- Zhvillimi “infrastrukturës së cilësisë” (standardizimi, akreditimi dhe meteorologjia) për të siguruar që produkti mund të plotësojë kërkesat e standardeve ndërkombëtare dhe të Bashkimit Evropian. Në një botë që është gjithnjë e më e globalizuar, suksesi në tregjet për eksport ndikohet gjithnjë e më shumë nga aftësia e qeverive të përkrahin një ambient që ndihmon shërbimet tregtare dhe logjistikën efikase dhe të lirë.

Politikat ekonomike për tejkalimin e kësaj gjendje duhet të kenë në fokus rritjen e bizneseve prodhuese, rritjen e aftësisë konkurruese dhe promovimin e eksportit. Dizajni dhe implementimi i strategjisë së integruar të promovimit të eksportit kërkon koordinimin e aktiviteteve nga Qeveria, shoqatat afariste dhe aktorë të tjerë në disa fusha të rëndësishme.

Gjithashtu duhet ndjekur politika e investimit në arsim dhe në trajnim profesional të kapitalit njerëzor dhe modernizimi i institucioneve të tregut të punës, duke patur objektiva të qarta dhe të matshme, stimulime financiare për zgjerimin e firmave të vogla dhe të mesme dhe kalimin e bizneseve nga ekonomia joformale në atë formale. Rëndësi të madhe për reduktimin e papunësisë kanë edhe politikat e tregut të punës.

Në krahasim me vendet e rajonit, Republika e Maqedonisë ka një përqindje të ulët të shpenzimeve për politikat aktive të tregut të punës në PBB, por ka një përqindje të lartë të shpenzimeve për politikat pasive të tregut të punës, në krahasim me vendet e tjera të rajonit.

Sa i përket kësaj strukture të shpenzimeve të politikave të tregut të punës, Maqedonia duhet të rrisë shpenzimet për politikat aktive të tregut të punës, duke reduktuar, nga ana tjetër shpenzimet për politikat pasive të tregut të punës.

Megjithëse këto rezultate janë për një periudhë kohore prej 16 vitesh dhe në model mund të përfshihen edhe variabla të tjera të papërfshira, faktikisht ky ishte objekt i këtij studimi, i cili paraqet një kontribut modest teorik dhe empirik për hulumtime të mëtejshme të kësaj fushe, me synim përfshirjen edhe të një numri më të madh variablash në model dhe një periudhë më të gjatë kohore të hulumtimit.

Bibliografia

Aliber, R. Z. 2003. *The Multinational Paradigm*. The MIT Press.

Arrow, K. J. 1962. "The Economic Implication of Learning by Doing", *The Review of Economic Studies*, fq. 155 - 173.

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë (2014), Indikatorët kryesorë makroekonomik, BPRM, Dhjetor 2014.

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë (2016), Indikatorët kryesorë makroekonomik,

Blomstrom dhe Kokko. 1998. "Multinational Corporations and Spillovers", *Journal of Economic Survey*, vol. 12.

Buckley dhe Casson. 1996. "An Economic Model of International Joint Venture Strategy", *Journal of International Business Studies*, Palgrave Macmillan, fq. 849-876.

Buckley dhe Casson. 1976. *The Future of Multinational Enterprise*. London: The Macmillan Press.

Balassa, B. (1985), "Exports, policy choices, and economic growth in developing countries after the 1973 oil shock", *Journal of Development Economics*, 18

Balassa, B., (1978) "Export and Economic Growth: Further Evidence", *Journal of Development Economics*, 5, 181 – 189.

Chenery, H, and Strout, A., (1966), "Foreign Assistance and Economic Development", *American Economic Review*, 56, 679 – 733.

Dickey. A. D and Fuller. A. W (1979). Distribution of the Estimators for Autoregressive Time Series With a Unit Root, *Journal of the American Statistical Association*, Vol. 74

Feder, G. Exports and Economic Growth", *Journal of Development Economics*, 12, 1982, pp. 59–73

Estrin S., Hanousek J., Kocenda E., and Svejnar J. (2009), The Effects of Privatisation and Ownership in Transition Economies. *Journal of Economic Literature*, 47 (3): 699–728

Borenzstein, E., De Gregorio, J., Lee, J-W. (1998), How does foreign direct investment affect economic growth? *Journal of International Economics* 45 (1998) 115–135.

Caves, R. E. (1996), *Multinational Enterprise and Economic Analysis*. Cambridge: Cambridge University Press.

Siliverstovs, B., Herzer, D. (2007) Manufacturing exports, mining exports, and growth: cointegration and causality analysis for Chile (1960-2001). *Appl Econ* 39: 153- 167.

Helpman, E., Krugman, P. (1985), Market structure and foreign trade. MIT Press, Cambridge, Mass.

Grossman GM, Helpman E (1991), Innovation and growth in the global economy. MIT Press, Cambridge, Mass.

Feder, G. (1983), On exports and economic growth. J Development Econ 12: 59-73.

Chuang Y-C (1998), Learning by doing, the technology gap, and growth. Int Econ Rev 39: 697-721.

Keho. Y. (2015), Foreign Direct Investment, Exports and Economic Growth: Some African Evidence. Journal of Applied Economics and Business Research JAEBR, 5(4): 209-219

Ghirmay, T., Garbowski, R., & Sharma, S. (2001) “Exports, Investment Efficiency and Economic Growth in LDC: an Empirical Investigation”, Applied Economics, 33, 689-700.

Hatemi-J., A., (2002) “Export Performance and Economic Growth Nexus in Japan: a Bootstrap Approach”, Japan and the World Economy, 14(1), 25-33.

Helpman, E., Krugman, P.R. (1985). Market Structure and Foreign Trade. Cambridge: MIT
Irwin, Douglas A., “Did Import Substitution Promote Growth in the Late Nineteenth Century?”, NBER

International Labour Office (2010-2017). Global Employment Trends, ILO, January, Geneva.

International Labour Office (2011). Global Employment Trends 2011: The challenge of a jobs recovery, ILO, Geneva.

International Labour Organization (2016). World Employment Socila Outlook: Trends 2016, ILO, Geneva.

International Monetary Found (2015). World Economic Outllok Database, October.

International Monetary Fund (2009). Staff Report for the 2009, Article IV Consultation, November 24.

International Monetary Fund (2015). World Economic Outlook, IMF, October.

International Monetary Fund (2016). World Economic Outlook, IMF, April.

PwC (2016): Guide to Doing Business and Investing in Macedonia.
<https://www.pwc.com/mk/en/publications/assets/doingbusinessguidemacedonia2016.pdf>

Државен завод за статистика, 2005-2017”. Република
Македонија.<http://www.stat.gov.mk/Publikacii/3.4.9.01.pdf>

- Pollozhani P. (2011). *Ekonomia për juristë: Makroekonomia*. Tetovë: ArberiaDesign.
- Lipsey dhe Kravis. 1982. "Location of overseas production and production for exports by US multinational firms", *Journal of International Economics*, fq. 201-223.
- Mankiw, Romer & Weil. 1992. "A Contribution to the Empirics of Economic Growth", *Quarterly Journal of Economics*, fq. 407-437.
- Markusen, J. 1984. "Multinationals, Multi-plant Economies, and the Gains from trade", *Journal of International Economics*, fq. 205-226.
- Krueger, A. (1980) "Trade Policy as an Input to Development", *American Economic Review*, 70, 288 – 292.
- Selimi, N. Rasim Z. & Sadudin I. Do Macedonia's exports have any significant impact on its economic growth?. In *International conference on research in Education and Sciences (ICRES)*, pp. 39. ICRES, Kusadasi, Turkey, 5 / 2017.
- Selimi, N., Sadiku, M and Sadiku, L. (2016). "The Impact of Foreign Direct Investments on the Economic Growth of Macedonia". 3- rd International Multidisciplinary Scientific Conference on Social Sciences and Arts, SGEM2016, Economics and Tourism, pp. 749-756. STEF92 Technology Ltd, Sofia, Bulgaria
- Shan, J., and Tian, G. (1998) "Causality Between Exports and Economic Growth: The Empirical Evidence From Shanghai", *Australian Economic Papers* 37 (2), 195 –202.
- Todaro. M. @ Smith C. S (2012) "Economic Development" 11th edition, Pearson AddisonWesley, USA
- Tyler, W. (1981), "Growth and export expansion in developing countries", *Journal of Development Economics* 9, pp 121- 30
- Yagmaian, B., (1994) "An Empirical Investigation of Exports, Development and Growth in Developing Countries: Challenging the Neo-Classical Theory of Export led Growth", *World Development*, 22, 1977-1995.
- OECD (2017), Tracking Special Economic Zones in the Western Balkans: Objectives, Features and Key Challenges.
- World Bank (2017), Western Balkans Regular Economic Report No.11. Faster Growth, More Jobs.
- World Bank (2017) Total Population [Data file] 20World Bank (2017). GDP in Current USD. [Data file] World Bank (2017), FDI net inflows (% of GDP) [Data file]

World Bank (2010-2017). —Doing Business in Macedonia, ".

World Bank (2015), World Development Indicators, Aprill 2015, <http://dataworldbank.org>

Петревски, Г. (2011) *Управување со банките* (второ издание), Скопје: Економски факултет, , стр. 91.

Standard & Poors. *Credit model*. New York: Standard & Poors.

Standard & Poors. February (2000.) *Rating Performans 1999: Stability & transition*. New York: Standard & Poors.

Закон за извршување, Службен Весник на РМ , 35/2005, 50/2006, 129/06 и 8/2008

Државен завод за статистика “*STRANSKI DIREKTNIIINVESTICII VO REPUBLIKA MAKEDONIJA, 2003-2016*”. Република Македонија. Е marrë me datë 17 Nëntor 2018, nga <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/3.4.9.01.pdf>